

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7853 E martë 16 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Satira e **Ditës**
A të natë shefi i madh kishte fjetur pa terezi. Një e flamuror ndërë që iu faneps nuk e la të qetë gjithë natën. Ndërroi krah e krevat dhe veç i shtojë ankthi ...
Vijon në faqen 20

Nga ERMAL MULOŠMANI
Mbledhje qeverie në Burrel


Dje në "Deutsche Welle"
Në negociatat e drejtuara nga Bashkimi Europian mes Kosovës dhe Serbisë për një marrëveshje gjithëpërfshirëse e përfundimtare për normalizimin ...
Vijon në faqen 21

Nga BODO WEBER
Beteja e fundit e Merkelit zhvillohet në Ballkan




29-vjeçari i stërviste dy djemtë e tij në banesë si luftëtarë të ISIS

Arrestohet ish-komando i ushtrisë, Erzern Uka, për veprime terroriste

Ish-komandoja ka shërbyer në Irak dhe Afganistan në vitin 2011. I riu po hetohej prej më shumë se dy vitesh

TIRANË - Ish-komando i ushtrisë, Erzern Uka, i cili ka shërbyer në Irak dhe Afganistan në vitin 2011 është arrestuar nga zyra Antiterrorit në Policinë e Shtetit. 29-vjeçari është vënë në pranga pas dyshimeve për prirje radikale dhe nxitjen e urrejtjes, me qëllim kryerjen e veprave terroriste. I arrestuari konsiderohet person me rrezikshmëri të lartë. Burime ...

Në faqen 7

VENDIMI / 7% ME SHUME PER 36 MIJE MESUES DHE RRETH 20 MIJE PUNONJES TE SHENDETESISE

TABELAT, SA DO TE RRITEIN PAGAT PER ÇDO KATEGORI

Shtesë page deri në 20% për 300 diplomatë dhe 3500 punonjës të Burgjeve. Sa përfitojnë ushtarakët, 15 mijë lekë në muaj për gradat madhore. Rritja nga 1 prilli për gjithsej 65 mijë veta



(Në foto) Mjekë, ushtarake (foto ilustruese)



Në faqen 12

MINISTRI ME SUPERKOMPETENCA

Vizitat e ministrave jashtë shtetit, në dorë të Gent Cakajt

Në faqen 5

KUMBARO

Makina të tonazhit të rëndë mbi kalldrëm në Gjirokastrë

Në faqen 19

REAGON PD

Padia për Lleshaj, Gazmend Bardhi: 40 protestues, në burg pa asnjë provë

Në faqen 2

GUVERNATORI

Gent Sejko: Ristrukturimi i bankave do të rrisë kreditimin

Në faqen 13

ZJARR NE PARIS



Francezët në lot, flakët bëjnë shkruamb katedralen Notre-Dame

Në faqen 15

Ministrja e Arsimit emëron Bernard Dostin në krye të rektoratit të Universitetit të Tiranës

Qeveria "heq" rektorin, Koni letër Metës

Mynyr Koni i kërkon ndihmë presidentit: Jam gati t'ju sqarohem

Mynyr Koni reagon pasi u pezullua nga detyra e rektorit të Universitetit të Tiranës. Ai thotë se një gjë të tillë e priste "pas gjithë atyre sulmeve të pashembullta që prej shumë kohësh janë adresuar ndaj personit tim", ndërsa shton se para se të merrte këtë vendim, Shahini



duhet minimalisht ta kishte pritur në një takim. Ai thotë ndër të tjera se pezullimi i tij është kërkuar nga qeveria e Ramës, prandaj i kërkon Presidentit të Republikës së Shqipërisë, "që me seriozitetin dhe gjaktohtësinë që e karakterizon, ta ...

Në faqen 8-9

OPOZITA AKUZAT

PD, Shehu: Shokuese, protestuesit të lidhur me pranga në shtrat nga krahu i dëmtuar

Valentina Madani

Opozita akuzoi dje po licinë e shtetit se po mban në burg pa asnjë provë 40 protestues ndërkohë që nuk u janë hequr prangat as në shtratin e Qendrës së Traumës në Tiranë. Sekretari i Përgjithshëm i PD-së, Gazmend Bardhi është thirrur në prokurori për padinë që kjo forcë politike ngriti një muaj më parë ndaj ministrit të Brendshëm Sandër Lleshaj dhe drejtuesve të lartë të policisë. Objekt-padia ka të bëjë me përdorimin e gazit lotsjellës ndërsa ministri akuzohet për veprime të paligjshme kundër protestuesve. Në një prononcim për median Bardhi i bëri thirrje prokurorisë të ushtronte detyrat e saj dhe të mos bëhet shtojcë e policisë së shteti dhe të mbrojë të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve. "Kam dhënë fakte nga PD mbi veprimet e kundërligjshme të drejtuesve të Policisë së Shtetit që me urdhër politik sulmuan qytetarët duke i penguar në ushtrimin e së drejtës së tyre të protestës. Sot ka 40 qytetarë në burg pa asnjë provë apo pamje filmike që ata të kenë kryer akte dhune dhe nuk ka asnjë hetim apo dënim ndaj atyre që ka shkelur ligjin dhe dhunuar qytetarët", u shpreh z.Bardhi. Zyrtari i lartë demokrat e quajti ministrin Lleshaj mbetje të komunizmit. "Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj është mbetje e kohës së komunizmit. Koha kur protesta trajtohej si puc ka përfunduar 30 vite më parë, nuk ka dhe nuk do të ketë asnjë ministër të Brendshëm asnjë drejtues policie që të mund të pengojë të drejtat themelore të qytetarëve. Të protestosh është e drejtë legjitime në demokraci vetëm për një mbetje komuniste si Sandër Lleshaj është puç kush-tetues", theksoi sekretari i përgjithshëm i PD-së. Madje Bardhi përcolli një mesazh për prokurorët: "Ape! im është për gjyqtarët e prokurorët. Nuk kanë për të kaluar vetingun duke i shërbyer në mënyrë kriminale qeverisë. Qytetarët nuk do të falin dhe do i trajtojnë çdo prokuror dhe gjyqtar njëjloj si banda që qeverisin sot vendin".

AKUZA

Ish-deputeti i PD-së, Tritan Shehu e quajti si shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut, prangosjen e protestuesve edhe në ambientet e qendrave spitalore. Shehu në një reagim thekson se asnjë pacient nuk mund të mbahet i prangosur në shtratin e spitalit, po ashtu asnjë polic nuk duhet të qëndrojë këtu

Padia për Lleshajn, Bardhi: 40 protestues, në burg pa asnjë provë

"Nuk kishte akte dhune ndaj policisë"



Protestuesit e prangosur në qendrën e traumës

Gazmend Bardhi

"Kam dhënë fakte nga PD mbi veprimet e kundërligjshme të drejtuesve të Policisë së Shtetit, që me urdhër politik sulmuan qytetarët duke i penguar në ushtrimin e së drejtës së tyre të protestës. Sot ka 40 qytetarë në burg pa asnjë provë apo pamje filmike që ata të kenë kryer akte dhune dhe nuk ka asnjë hetim apo dënim ndaj atyre që kanë shkelur ligjin dhe dhunuar qytetarët", - tha z.Bardhi.

Tritan Shehu

"Shkelje e rëndë e të drejtave themelore të njeriut e të pacientit, dhunim i institucionit shëndetësor. Pamjet e pacientit të plagosur, të lidhur me pranga në shtrat nga krahu i dëmtuar, në një pozicion të detyruar e rëndues ky, me policë që e rrethojnë, janë shokuese", - tha ish-deputeti i PD-së.

ada domos së tij. Për ish-deputetin drejtuesit e spitaleve dhe mjekët nuk duhet ta lejonin këtë, që spitali të kthehej në pronë të policisë. "Shkelje e rëndë e të drejtave themelore të njeriut e të pacientit, dhunim i institucionit shëndetësor. Pamjet e pacientit të plagosur, të lidhur me pranga në shtrat nga krahu i dëmtuar, në një pozicion të detyruar e rëndues ky, me policë që e rrethojnë, janë shokuese. Fatkeqësisht kjo

"Asnjë hetim për djegien e makinës"

Protesta, Vasili: Shtet gangsterësh, që rëmben njerëz në mes të rrugës

Ish-deputeti i LSI Petrit Vasili hodhi dje akuzat të forta mbi qeverinë dhe policinë për arrestimin dhe dhunimin e protestuesve. Sipas tij, shteti po dhunon qytetarët dhe çdo normë demokratike. Për Vasilin, qytetarët janë përballur me dhunën, pa akuzë, të rrembyer, në mes të natës, vetëm me fjalë goje. Ai theksoi në tej se sot e kësaj dite nuk zbardhet përse u mbajt në errësirë i gjithë sheshi i protestës, ndërkohë që policia çirrej në mënyrë hysterike, kërkonte mbarëvajtjen e protestës, krijoi premisën themelore që protesta të provokohej, pavarësisht se opozita nuk u provokua. "Kush ishte pronari i au-



tomjetit? Kush ishte autorët? Kush ishte ata që tentuan të digjin dhe kioskën afër automjetit? Përse nuk ka hetim? Përse nuk ka të dyshuar? Përse nuk ka të ndaluar? Fyete të mëdha, të cilave asnjëherë nuk u përgjigjen, përveçse mashtrimeve pa fund të Ministrisë së Brendshme. Së dyti, është pretenduar gjerazi nga policia për gjoja dëmtime të forcave


në shtrat në spital, asnjë polic nuk mund të qëndrojë brenda domos së tij të spitalit, ky është një parim universal, që mund të tejkalohet për kohësisht vetëm n.q.s. personeli mjekësor e kërkim këtu gjë, gjë që nuk ka ndodhur në këtë rast. Spitali nuk është pronë e policisë, pacientit pavarësisht përse akuzohet, nuk është skllav që ruajtësi mund të bëjë çfarë të dojë me atë! Spitali drejtohet nga drejtuesit e tij e mjekët, veçanë-

REAGIMI

Kreu i Bashkisë së Kavajës, Isa Sakja, e cilësoi padinë e IKMT-së ndaj tij një sulm politik të dirigjuar nga kryeministri Edi Rama. Sipas tij, gjithçka lidhet me sondazhet e kryera në Kavajë, që të gjithë kandidatët potencialë socialistë dalin në humbje. Sakja garanton se si kryebashkiak i Kavajës do të vazhdojë të përmbushë me përkushtim detyrën e tij.



Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, në protestën e 13 prillit



Strazimiri, Lleshaj: Sulm opozitës, por krimi ka marrë dhenë

Ish-deputeti i PD Gent Strazimiri shprehet se ndërkohë që Sandër Lleshaj merrej me "goditjen e elementëve opozitarë", drejt Shqipërisë po nisen 91 kg kokainë me vlerë mbi 10 milionë euro. Strazimiri përmend se Sandër Lleshaj e kishte mendjen si të sulmonte opozitën, ndërsa krimi ka marrë dhenë, që nga grabitja në Rinas, e deri në trafiket ndërkombëtare të drogës. "Ndërkohë që "zbulojë" dhe "parandaloje" atë "planin e opozitës" për të "sulmuar institucionet", dikush po të realizonte planin për të sulmuar Shqipërinë me breshëri me kokainë të pastër! 91 kg kokainë me vlerë 10.3 milionë euro me destinacion Shqipërinë! Domethënë 1 "Rinas" kokainë 3 herë rresht, o Llesh! Po nga i njëjti port i Maltës, drejt të njëjtit port të Shqipërisë! Që "Rinas" (megjithëse i realizuar po ashtu 3 herë në të njëjten derë, në të njëjten orë, nga i njëjti "organizator", për më tepër "në kërkim"), ka vështirësi të zbulohet e të parandalohej po e pranojmë, aq më tepër kur ka një "kinez" në mes...", theksoi ish-deputeti i PD-së.



"Brukseli të sjellë ekspertë të pavarur për monitorimin e situatës në Shqipëri"

Basha në Slloveni: KE të monitorojë sundimin e ligjit në Shqipëri

"Shqipëria si Europa, ne e kemi bërë zgjedhjen"

Valentina Madani

Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, i pranishëm dhe në Lubjanë të Sllovenisë, i ftuar i Institutit Ndërkombëtar të Studimeve për Lindjen e Mesme dhe Ballkanin kërkoi që Bashkimi Evropian të monitorojë sundimin e ligjit në Shqipëri, një nismë e cila është ndërmarrë tashmë për Bosnje Hercegovinën. Lideri demokrat gjatë fjalës së tij kërkoi aplikimin në Shqipëri të ashtuquajturit "Raporti Priebe". Z.Basha e vuri theksin te "Raporti Priebe", i cili sipas tij ndihmoi në tejkalimin e një krize serioze të demokracisë dhe sundimit të ligjit në Maqedoni në 2015-ën. "Monitorimi më efektiv i reformave të sundimit të ligjit në vendet që kërkojnë anëtarësim mund të arrihet duke u mbështetur në shembullin pozitiv të ashtuquajturit 'Raporti Priebe', i cili tashmë ndihmoi në tejkalimin e një krize serioze të demokracisë dhe sundimit të ligjit në Maqedoni në 2015-ën. Komisioni Evropian sapo ka nisur një nismë të re për raportimin e Priebe për të monitoruar të gjithë sistemin e sundimit të ligjit në Bosnje dhe Hercegovinë. Unë inkurajoj Komisionin që të iniciojë një mision të tillë monitorimi edhe në Shqipëri", - deklaroi në Slloveni kreu i opozitës, Lulzim Basha.

pak javë nga vendimi për hapjen ose jo të negociatave me Bashkimin Evropian.

DEKLARATA

Po dje Lulzim Basha deklaroi se opozita e ka bërë zgjedhjen e saj dhe do të qën-

drojë në krah të qytetarëve. Në një postim në "Facebook", kryetari i Partisë Demokratike shprehet se do ta luftojë këtë "qeveri-bandë", që është kapur duke vjedhur në zgjedhje. Sipas tij, "populli

tani i ka vënë kryqin kësaj bande hajdute dhe nuk do të ndalet". Basha e mbyll regjimin e tij me togfjalëshin "Shqipëria, si Europa" të shkruar në një hashtag. "Ne e kemi bërë zgjedhjen: me njerëzit kundër një qeverie-bandë dhe kryehajdutit të saj, që pasi i ka vjedhur dhe braktisur, tani i dhunon dhe i helmon ata! Ky kryeministër hajdut është kapur duke vjedhur shqiptarët dhe duke blerë votat e tyre bashkë me krimin. Kjo qeveri-bandë u vuri kryqin shtëpive të shqiptarëve, i ka vënë kryqin të ardhmes sonë europiane. Prandaj tani populli i ka vënë kryqin kësaj bande hajdute dhe nuk do të ndalet", - shprehet z.Basha. Regjimi i kreut të PD-së vjen dy ditë pas protestës kombëtare në Tiranë të opozitës së bashkuar, ku pati përplasje me protestuesve dhe policisë.



Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, dje në Lubjanë të Sllovenisë

MONITORIMI

"Komisioni Evropian sapo ka nisur një nismë të re për raportimin e Priebe për të monitoruar të gjithë sistemin e sundimit të ligjit në Bosnje dhe Hercegovinë. Unë inkurajoj Komisionin që të iniciojë një mision të tillë monitorimi edhe në Shqipëri", - deklaroi në Slloveni kreu i opozitës, Lulzim Basha.



Raporti i 'Strasburgu', PD: Rama, kundër pronës private

Tabaku: 14 milionë euro dëme, 'Strasburgu' u dha të drejtë pronarëve

Ish-deputetja e PD-së, Jorida Tabaku, përmes një postimi në "Facebook" shprehet se Shqipëria zë vendin e parë sa u takon çështjeve të pronësisë në raportin e fundit të Gjykatës Europiane. Sipas Tabakut, vetëm vitin e kaluar Gjykata Europiane ka kaluar rreth 14 milionë euro dëme në llogari të shtetit shqiptar, e cila u jep të drejtë pronarëve të ligjshëm. Tabaku numëron me fakte pasojat negative kundër pronës private e publike, që qeveria "Rama" u ka lënë në kurriz shqiptarëve në 6 vite. Ish-deputetja tekta bën një bilanc të reformave dhe vendimeve të marrë nga qeveria aktuale e cilëson kryeministrin Edi Rama si një hajdut. Ndër të tjera, ajo thekson se ka ardhur koha që prona të vlerësohet dhe pronari të respektohet dhe jo të përdoret për interesa personale nga qeveritarët. Në një shënim në faqen e saj në "FB", Tabaku thekson se sipas të dhënave të Gjykatës Europiane të Strasburgut, vetëm vitin e kaluar numërohen 14 milionë euro dëme për shtetin, pasi kjo gjykatë u ka dhënë të drejtë pronarëve të ligjshëm. "Në raportin e fundit të Gjykatës Europiane mbi çështjet në gjykim dhe vendimet e saj, Shqipëria zë vendin e parë sa u takon çështjeve të pronësisë. Plaga e buxhetit të shtetit, ekonomisë, por edhe pronarëve vazhdon të lëngojë, ndërsa drejtësia kërkon të zbatohet. Fatqësisht, qeveria dhe njerëzit që e drejtojnë atë në gjashtë vite kanë prodhuar vetëm ligje që nuk i shërojnë plagët, por i përkeqësojnë", shprehet ish-deputetja e PD-së.

RAPORTI

Në 2017-ën, në momentin e krizës së thellë politike, së bashku me ndërmjetësimin diplomatik midis aktorëve politikë në Maqedoni, Brukseli mboldhi një grup ekspertësh të pavarur, të udhëhequr nga ish-drejtori për Ballkanin në Komisionin Evropian, Reinhard Priebe për të identifikuar çështjet sistematike të sundimit të ligjit. Hetimi asokohe në vendin fqinj çoi në të ashtuquajturin "Raporti Priebe". Ekspertët e pavarur nga vendet anëtare të BE-së identifikuan problemet e demokracisë, duke shkuar më thellë se raportet e zakonshme të BE-së. "Raporti Priebe" u porosit dhe publikua nga Komisioni Evropian çka i dha peshë më të madhe. Lulzim Basha kërkoi nga Brukseli që një gjë e tillë të aplikohet edhe në Shqipëri, në një moment kur na ndajnë vetëm

"Kosova në NATO, siguri për Ballkanin"

Meta në Romë: Shqipëria, promotore e palodhur e stabilitetit

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, ishte i "Ftuar Nderi" në Kolegjin e Mbrojtjes së NATO-s në Romë, ndërsa vlerësoi prezencën e Aleancës në Ballkanin. Perëndimor, referuar "ekspansionit gjeostrategjik" në rritje të aktorëve të tretë, shtetërorë dhe joshitetërorë. Kreu i shtetit shqiptar vlerësoi edhe përgjdhjen e Kuçovës si vendndodhje të bazës moderne ajrore të NATO-s, si një investim strategjik në dobi të sigurisë sonë kombëtare, rajonit, projekteve dhe qëllimeve afatgjata të Aleancës në Ballkanin Perëndimor dhe më tej dhe shpreheje e mirëbesimit reciprok e vlerësimit të kontributit të Shqipërisë në gjirin e Aleancës. Meta kërkoi nga Aleanca që të bënte pjesë të saj sa më shpejt edhe Kosovën. "Shqipëria mendon se përshpejtimi i hapave të Kosovës dhe vendeve të mbetura të rajonit drejt NATO-s dhe Bashkimit Evropian do t'i shërbente jo vetëm sigurisë dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të Ballkanit, por edhe bashkëpunimit dhe zhvillimit ekonomik dhe rritjes së investimeve të huaja, krye-



sist nga vendet e Aleancës dhe të Bashkimit Evropian", - tha Meta. Presidenti përmendi se, "Shqipëria garanton përmbushjen e përgjegjësisë të saj, angazhimin dhe përkushtimin e solidaritetin në dobi të 'mbrojtjes dhe sigurisë kolektive' të çdo anëtar të NATO-s dhe të interesave strategjike të Aleancës. Shqipëria ka vënë në dispozicion infrastrukturën e saj në dobi të sigurisë kolektive dhe për operacionet dhe stërvitjet e Aleancës, duke u shtuar si një partner i besueshëm i saj dhe lider në të gjitha nismat rajonale, me qëllim rritjen e masave të besimit me vendeve të rajonit, forcimin e bashkëpunimit dhe ndarjen e përvojës së saj të anëtarësimit". Presidenti e mbylli fjalimin e tij duke

CF

SFIDAT

"Shqipëria është e vendosur jo vetëm të ruajë këtë paqe të fituar me aq mund, por mbetet seriozisht e angazhuar edhe në sfidat e përbashkëta gjeostrategjike me të cilat përballet sot Aleanca në rajon dhe më gjerë", tha z.Meta.

thënë: "Shqipëria është e vendosur jo vetëm të ruajë këtë paqe të fituar me aq mund, por mbetet seriozisht e angazhuar edhe në sfidat e përbashkëta gjeostrategjike me të cilat përballet sot Aleanca në rajon dhe më gjerë. Ajo është e gatshme të marrë të gjitha përgjegjësitë që i kërkon, veçanërisht në përmbushjen e rolit të saj të pazëvendësueshëm si faktor stabiliteti në rajon, si promotore e palodhur e bashkëpunimit dhe integritetit rajonal, si mbështetëse e vendosur e politikës së "Dyerve të hapura" të NATO-s dhe si partnerë strategjike e Aleancës përmes një politike të jashtme koherente dhe të besueshme".

DIPLOMACIA REFORMA

Ministri u përplas me shefin e kabinetit: Boll se po flas unë, pastaj fol ti

Cakaj ngre tonet dhe godet tavolinën: Merreni me kë bashkëjetoj unë

Kreu i diplomacisë zhvilloi dje një mëngjes pune me gazetarët

Ministrin e deleguar për Europën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj duket se kanë filluar ta tradhtojnë shpejt nervat. Përgjegjësia dhe presioni mediatic, kanë bërë që ai të mos ndihet më i qetë, si edhe më parë. Dhe kjo është reflektuar dje gjatë një mëngjesi pune me gazetarët që ai ka zhvilluar në vazhden edhe të një tradite tashmë të vendosur nga paraardhësi i tij në këtë detyrë, Ditmir Bushati. Por ndërsa ky takim ishte krejt informal, Cakaj nuk ka arritur dot që ta menaxhojë pavarësisht se gazetarët që kishte ftuar në mëngjes e dinin se bëhej fjalë për një takim jo zyrtar dhe që do synonte të afroonte sa më shumë ministrin e ri me median dhe sidomos me ata gazetarë që e mbulojnë kryesisht. Burime nga ky takim kanë bërë të ditur se në disa raste ministrin Cakaj nuk e kanë mbajtur nervat, ndërsa në një rast ka qëlluar fortë edhe tavolinën. Ai gjatë këtij takimi mësohet se u nervozua me gazetarët dhe me vartësit e tij dhe shkak janë bërë disa çështje që kanë hapur debat në opinionin publik. Kështu, duke folur për çështjen e reformës në shërbimin diplomatik dhe largimin e ambasadorëve dhe diplomatëve nga përfaqësitë tona në botë, Cakaj tha se ata kanë shkelur ligjin dhe kanë abuzuar me detyrën, ndërsa nuk pranoi argumentin se ky ishte dhe një lloj linçimi publik i tyre. Ai u ka kujtuar gazetarëve se nuk mund të konsiderohet shkelje dinjiteti i ambasadorëve shkarkimi apo lëvizja e tyre i bazuar mbi argumente dhe një analizë të mirëfilltë të punës së tyre, ndërsa nga ana tjetër media është marrë edhe me jetën e tij private. "Ju që më gjykonni mua për veprimin tim duke mbrojtur ambasadorët pasi e quani shkelje të dinjitetit të tyre, largimin nga puna në këtë mënyrë, shkoni deri aty sa merreni me kë bashkëjetoj unë. Keni qenë ju që keni folur për mua, duke mos menduar se kjo është një shkelje e dinjitetit tim.

TAKIMI

Ai ka zhvilluar dje një mëngjes pune me gazetarët, në vazhden edhe të një tradite tashmë të vendosur nga paraardhësi i tij në këtë detyrë, Ditmir Bushati. Por ndërsa ky takim ishte krejt informal, Cakaj nuk ka arritur dot që ta menaxhojë pavarësisht se gazetarët që kishte ftuar në mëngjes e dinin se bëhej fjalë për një takim jo zyrtar dhe që do synonte të afroonte sa më shumë ministrin e ri me median dhe sidomos me ata gazetarë që e mbulojnë kryesisht.



Ministri i deleguar për Europën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj

Të gjithë ata që e gjykojnë vendimin tim për ambasadorët, janë meskinë", - mësohet të jetë shprehur Cakaj. Por nuk ishte ky i vetmi episod që ndodhi gjatë këtij takimi, pasi ai në disa raste u përplas edhe me vartësit e tij në ministri dhe që ndodheshin në këtë takim. Kështu gjatë takimit, Cakaj u përplas me drejtorin e tij të Kabinetit, i cili po i përgjigjej pyetjes së një gazetari lidhur me një çështje të caktuar. Cakaj ka ndërhyrë në këtë rast teksa shefi i Kabinetit fliste duke i thënë: "Boll se po flas unë, jam unë këtu, pastaj fol ti", ndërsa i ra tavolinës me grusht. Situata ka vijuar e ndërë deri në fund të bisedës, ndërsa një tjetër episod i ngjashëm ka ndodhur sërisht me një nëpunës të Ministrisë Jashtme dhe ku shkak është bërë interesi i një prej gazetarëve të pranishëm mbi çështjen

e ambasadorit të Iranit në vendin tonë. Cakaj nuk e ka lejuar nëpunësin e vet që të japë shpjegime lidhur me këtë çështjeje, ndërsa ka bërë të ditur se rreth kësaj teme nuk ka një zhvillim tjetër veçse atij që është bërë më parë publik. Cakaj mori detyrën e kreut të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme pasi kryeministri Edi Rama, i delegoi atij kompetencat e ministrit. Që me ardhjen e tij në krye të kësaj ministrie janë ndërmarrë disa veprime demonstrative që janë konsideruar si pjesë e reformës që ka përfshirë këtë institucion, duke filluar me largimin apo lëvizjen e ambasadorëve dhe diplomatëve të emëruar në kundërshtim me ligjin, heqjen e targave diplomatike konsujve të nderit si dhe heqja e pasaportave diplomatike për personat që nuk i takon.

Kryeministri Edi Rama dhe ministri i deleguar për Europën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj



Grabitja në Rinas, opozita e re thërret Lleshajn në interpelancë

Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj do jap llogari të enjten në seancë plenare mbi ngjarjen e javës së shkuar të ndodhur në Aeroportin e Rinasit, ku u grabitën rreth 7 milionë euro. Deputetët e opozitës së re parlamentare, kanë depozituar në Kuvend kërkesën për interpelancë me ministrin e Brendshëm Sandër Lleshaj me objekt pikërisht grabitjen e ndodhur në Rinas. Nisma për të thirrur ministrin e Brendshëm u paralajmërua javën e shkuar, ndërsa dje dy opozitarët, Ralf Gjoni i zgjedhur nga listat e LSI-së dhe demokrati Myslim



Murrizi, i përjashtuar nga PD-ja, kanë konkretizuar atë. Sipas kërkesës së depozituar në Kuvend opozita e re kërkon sqarime për planin e masave të policisë së shtetit dhe agjencive të tjera për ruajtjen e rendit publik. Kërke-

sa është firmosur nga 10 deputetë të opozitës. Në seancën e kaluar, Ralf Gjoni i kërkoj ministrit Lleshaj që, nëse kapen autorët dhe nuk gjenden paratë brenda 2-3 javëve të japë dorëheqjen. Ministri Lleshaj është vënë në qendër të kritikave dhe akuzave nga ana e opozitës, si personi përgjegjës për mungesën e sigurisë në Aeroportin e Rinasit. Ndërkohë që vet Lleshaj ka hedhur poshtë këto akuzë duke deklaruar se policia arriti të reagojë në kohë dhe se përgjegjësia për sigurinë e aeroportit është e kompanisë koncesionare.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje pjesë këmbimi, mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 4,000,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfuttesi: Banka e Shqipërisë
IBAN: STANALTR
BIC: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje pjesë këmbimi, mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"**

Oftera duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **10 Maj 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



Rama i ka kaluar atij të drejtën organizimit të marrëveshjes ndërkombëtare

Vizitat e ministrave jashtë shtetit, në dorë të Gent Cakajt

Ministri i ri, me superkompetenca

Të gjitha vizitat zyrtare dhe të punës të të gjithë anëtarëve të kabinetit qeveritar "Rama" do jenë në dorë të ministrit në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj. Kryeministri Edi Rama, i cili njëherësh mban edhe pozicionin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, i ka deleguar Gent Cakajt një sërë kompetencash të tjera, mes të cilave edhe ato për dhënien mendimit për miratimin e vizitave zyrtare dhe të punës së anëtarëve të Këshillit të Ministrave jashtë shtetit. Urdhri i delegimit të kompetencave është publikuar dje në Fletoren Zyrtare, duke marrë kështu fuqi vepruese.



AMBASADORËT

Cakaj vendos për emërimin dhe mbarimin e detyrës së diplomatëve në misionet diplomatike/poste konsullorë të Republikës së Shqipërisë, transferimin, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë të personelit të karrierës diplomatike, si dhe i sugjeron kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, propozimin për emërimin dhe lirin e ambasadorit, të kreut të misionit diplomatik dhe konsullit të përgjithshëm.



Përurohet busti i Skënderbeut, Ruçi shpallet "Qytetar Nderi"

Qyteti arbëresh Portocannone dje ishte veshur kuq e zi. Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, i shoqëruar nga kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla; kryetarja e Komisionit të Jashtëm dhe kryetare e Grupit të Miqësisë me Italinë, Mimi Kodheli vizitoi rajonin Molise, ku përuroi bustin e Skënderbeut, si dhe u nderua me titullin "Qytetar Nderi", i Portocannones. Për të pritë delegacionin shqiptar kishin dalë me qindra banorë të qytetit, autoritetet lokale dhe fëmijët e shkollave. "Është një nder i madh për qytetin tonë të kemi mes nesh për herë të parë një autoritet të lartë shtetëror nga Shqipëria. Dhe këtë respekt na e bëri kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi. Ne i jemi atij thellësisht mirënjohës për nxitjen e lidhjeve dhe bashkëpunimit të katër komunave arbëreshe të rajonit Molise me Shqipërinë dhe për sjelljen mes nesh të bustit të heroit kombëtar të shqiptarëve, Skënderbeut dhe qyteti nderohet duke i dhënë Ruçit titullin "Qytetar Nderi", - tha kryetari i bashkisë, Giuseppe Caporicci. Më pas, ata përruan bustin e Skënderbeut, veprë e "Sculpitorit të Popullit" Mumtaz Dhrami, dhuruar Bashkisë së Portocannones, nga Këshilli i Qarkut Tiranë. "Nuk mund të ketë prosperitet, paqe dhe siguri nëse popujt, kombet dhe forcat progresiste nuk bëhen bashkë kundër të këqijave të kohës", - tha Ruçi në fjalën e tij, duke falënderuar kryetarin e bashkisë për mikpritjen.

KOMPETENCAT E DELEGAUARA

- Ndjekjen e zbatimit të programit të qeverisë së politikën e jashtme. Bashkërendimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së strukturave të shërbimit të jashtëm dhe raportimin para kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme.
- 1. Emërimin e Komisionit të Karrierës Diplomatike.
- 2. Emërimin e nëpunësit në sistemin e karrierës diplomatike.
- 3. Dhënien e gradave diplomatike sipas propozimeve të Komisionit të Karrierës Diplomatike.
- 4. Dhënien e masave disiplinore, sipas propozimit të Komisionit të Karrierës Diplomatike.
- 5. Punësimin e diplomatit të karrierës në organizata ndërkombëtare për periudha të përkohshme e në misionet diplomatike dhe postet konsullorë të Republikës së Shqipërisë.
- 6. Ngritjen e komisionit të posaçëm për përzgjedhjen e sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.
- 7. Emërimin/mbarimin e detyrës së diplomatëve në misionet diplomatike/poste konsullorë të Republikës së Shqipërisë.
- 8. Transferimin, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë të personelit të karrierës diplomatike, në bazë të propozimit të sekretarit të përgjithshëm.
- 9. Mbikëqyrjen e veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik.
- 10. Dhënien mendimi kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme për miratimin e vizitave zyrtare dhe të punës së anëtarëve të Këshillit të Ministrave jashtë shtetit.
- 11. Sugjeron kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, të propozimit për emërimin dhe lirin e ambasadorit, të kreut të misionit diplomatik dhe konsullit të përgjithshëm.
- 12. Dhënien e mendimeve për projekt-marrëveshjet ndërkombëtare, që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave, ministrive dhe institucioneve qendrore dhe çdo lloj mendimi tjetër institucional në lidhje me veprimtarinë me jashtë të institucioneve publike.
- 13. Marrjen e masave organizative në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave, me autorizim të presidentit, kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme.
- 14. Nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat lidhen në emër të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.
- 15. Kryesimin e delegacionit shtetëror përgjegjës për zhvillimin e dialogut politik dhe të negociatave me institucionet e Bashkimit Evropian.

që më parë bëri të ditur se nuk do të pranonte që Cakaj të firmoste një marrëveshje në emër të Shqipërisë. Nga ana tjetër, Rama i ka lejuar Cakajt të drejtën që të mund të firmosë të gjitha marrëveshjet e tjera që lidhen në emër të Ministrisë së Jashtme. Ndërkohë që sa i përket veprimtarisë së brendshme të vetë ministrisë, Cakaj duket se ka fuqi të pakufizuara vendimarrjeje. Si

pas këtij udhëzimi, ai mund të bëjë emërimin e Komisionit të Karrierës Diplomatike, emërimin e nëpunësit në sistemin e karrierës diplomatike, dhënien e gradave diplomatike sipas propozimeve të Komisionit të Karrierës Diplomatike, dhënien e masave disiplinore, punësimin e diplomatit të karrierës. Jo vetëm kaq, por Cakaj vendos për emërimin dhe mbarimin e detyrës së

diplomatëve në misionet diplomatike/poste konsullorë të Republikës së Shqipërisë, transferimin, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë të personelit të karrierës diplomatike, si dhe i sugjeron kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, të propozimit për emërimin dhe lirin e ambasadorit, të kreut të misionit diplomatik dhe konsullit të përgjithshëm.

DURRËS - Gjykata e Shkallës së Parë në Durrës ka vendosur të ekstradojë drejt Britanisë së Madhe 23-vjeçarën Elton Sefa, i shpallur në kërkim ndërkombëtar, pasi akuzohet për vrasjen e 47-vjeçarit John Woodward në 17 prill të vitit 2018. Ndërkaq, avokati mbrojtës i 23-vjeçarit që është arrestuar nga policia shqiptare ka kërkuar pezullimin e këtij vendimi duke paraqitur para gjykatës dhe prokurorit Ilir Turja një sërë dokumentesh që



Gjykata vendos ekstradimin në Angli të 23-vjeçarit të akuzuar për vrasje, avokati: Është i sëmure mendor

vërtetojnë se i riu është i papërgjegjshëm mendërisht me diagnozën çrregullim psikotik. Avokati Arsen Çauhaj i ka kërkuar trupit gjykuat që përfaqësohet nga Rexhep Bekteshi të caktojë ekspert mjeko-ligjor për të kryer ekzaminimin psikiatriko-ligjor të klientit të tij.

Rezultoni se 23-vjeçari është kthyer nga Anglia i papërgjegjshëm mendërisht dhe është shtruar në spitalin psikiatrik në Tiranë. Por këto dokumente nuk janë marrë parasysh as nga prokuroria dhe as nga gjykata. Ndërkohë, babai i 23-vjeçarit tregoi kalvarin dhe

fatin mizor që e priti të birin në Angli. Sipas Elmi Sefës djali iku në Angli me kamion, por u gjet në vendin ku humbi jetën aksidentalisht shtetas britanik, ndërsa shpjegoi se u largua nga vendi ku kishte ndodhur ngjarja nga frika, sepse ishte pa letra. I riu pa doku-

mente është larguar nga vendi i ngjarjes dhe nga Britania 8 javë pasi kishte mbërritur atje. Në gjendje të rënduar mendore ka ardhur në shtëpi i pavetëdijshëm, çka bëri që familja të kërkonte ndihmë në spitalin psikiatrik. Gjykata e Durrësit nuk e ka pranuar kërkesën e mbrojtjes për ekzaminim ligjor, ndërsa familja dhe mbrojtësi do vazhdojnë betejën ligjore për të anuluar vendimin e ekstradimit drejt Anglisë. **kl.ha.**

Autori Valter Ksolla u kap në Grudë, përfundojnë në pranga edhe 2 vëllezërit

SHKODËR

Pas dy vitesh në arrati, policia e Shkodrës ka arrestuar një 23-vjeçar të akuzuar për plagosjen me armë të ish-boksierit të "Vllaznisë" Nelson Hysa, i cili aktualisht ndodhet në burg si pjesë e grupit "Bajri". Ndërsa i arrestuar është Valter Ksolla, banues në lagjen "Mark Lula" të qytetit verior. Sipas policisë së bashku me të janë arrestuar edhe dy vëllezërit e tij. Atentati ndodhi në 6 maj të vitit 2017, ku i riu Ksolla në atë kohë i bëri pritë Nelson Hysës, i cili ra në pranget e policisë më 9 mars të këtij viti si pjesë e grupit të organizuar kriminal "Bajri". Gjykata e Shkodrës kishte caktuar ndaj Ksollës, masën e arrestit me burg për veprat penale të "Vrasjes me paramendim, e kryer në bashkëpunim" mbetur në tentativa, dhe "Prodhimi e mbajtje pa leje e armëve dhe municioneve luftarake". Në flagrancë u arrestuan edhe dy vëllezërit e tij, Ndue e Kolë Ksolla, përkatësisht 32 dhe 25 vjeç, të cilët sipas policisë përkrahen 23-vjeçarin duke e strehuar. Ndaj tyre rëndon edhe akuzat: "Prodhimi dhe mbajtje të armëve luftarake". "Finalizohet me sukses operacioni policor i koduar "Gruda". Kapet dhe ndalohet autori i dyshuar i ngjarjes së ndodhur me datë 06.05.2017, ku ka mbetur i plagosur shtetasi N.H.. Nga strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë

Sulmoi me armë anëtarin e grupit "Bajri", arrestohet pas 2 vitesh 23-vjeçari

Atentati në maj të 2017-ës, ish-boksieri i "Vllaznisë", Nelson Hysa mbeti i plagosur



Ish-boksieri i "Vllaznisë", Nelson Hysa

Shkodër pas një pune të mirorganiuar, u finalizua operacioni policor "Gruda" ku u bë kapja dhe ndalimi i shtetasit në kërkim: V.K. 23 vjeç, banues në Lagjen "Mark Lula", Shkodër. Ndalimi i tij

u bë pasi Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër, ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprat penale të "Vrasjes me paramendim, e kryer në bashkëpunim" mbetur në tentativa, dhe "Prodhimi

mi e mbajtje pa leje e armëve dhe municioneve luftarake", parashikuar nga nenet 78, 22, 25 e 278 të Kodit Penal, pasi është autor i dyshuar për ngjarjen e ndodhur me datë 06.05.2017", thuhet ndër të

tjera në njoftimin zyrtar të policisë së Shkodrës. Gjithashtu, në njoftim bëhet me dije se "si rezultat i këtij operacioni u arrestuan në flagrancë shtetasit N. K., 32 vjeç dhe K. K., 25 vjeç, banues në fshatin Grudë e Re, (vëllezër) për veprat penale: "Përkrahja e autorit të krimit", "Prodhimi e mbajtje pa leje e armëve dhe municioneve luftarake" dhe "Kanosja", pasi këta dy shtetas kishin strehuar në banesën e tyre shtetasin në kërkim V. K. dhe dyshohet se me datë 14.04.2019 kanë qëlluar me armë zjarri në drejtim të banesës së shtetasit L.A., 50 vjeç, banues në fshatin Grudë e Re, Shkodër. Materialet u referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për veprime të mëtejshme".

Krimet e Rënda refuzojnë kërkesën

Ish-deputetët e PS-së, Ndoka dhe Çuko, mbeten në "arrest shtëpie"

TIRANË - Dy ish-deputetët e PS Arben Çuko dhe Arben Ndoka mbeten në "arrest shtëpie". Mësohet se Gjykata e Shkallës së Parë e Krimeve të Rënda refuzon kërkesën e ndryshimit të masës së sigurisë për dy ish-deputetët e PS, Arben Ndoka dhe Arben Çuko. Ndërkohë, avokati i Arben Ndokës, Maks Haxhia ka theksuar se ka apeluar vendimin për sekuestron e pronave në emër të familjes Ndoka. Sipas tij, nuk ka asnjë metër tokë në emër të Ar-

ben Ndokës. Çuko dhe Ndoka u vunë në pranga në tetor të 2018, gjatë operacionit të policisë të koduar "Volvo 4", ndërsa më 15 nëntor 2018 Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda vendosi t'i linte në "arrest shtëpie". Kjo masë u caktua edhe për tre persona të tjerë që ishin të arrestuar, përkatësisht: Zef Lazri, Elis Guri si dhe Paulin Simonin, ndërkohë për Lule Zenelin u caktua masa "detyrim paraqitje". Më 22 tetor 2018, Policia e Shtetit nën drejtimin e Prokurorisë për Krimet e Rënda dhe në bashkëpunim



me agjencitë të tjera ligjzbatuese finalizuan një megaoperacion të koduar "VOLVO 4", të shtirë në 12 qytete nga Hasi deri në Sarandë ku u goditën anëtarë nga 4 grupe të shkuara kriminale, në kuadër të operacionit "Forca e Ligjit".

Trafiku i ndërkombëtar i drogës, nis gjykimi i grupit të Habilajve

TIRANË - Gjykata për Krime të Rënda nis gjykimin e grupit të Habilajve, ndërsa seanca e parë ka dështuar, për shkak të mos njoftimit të të pandehurve. Prej dy vitesh, Habilaj dhe një pjesë e grupit të tij, janë në arrest në burg në Itali dhe janë duke u gjykuar për të njëjtat vepra penale, ndërsa Krimet kanë bërë njoftimet në Vlorë, duke angazhuar policinë e rrethit. Me tej, gjykata ka kërkuar edhe ndihmën e Interpol, por ende nuk ka marrë një përgjigje. Në këto kushte, deri në njoftimin zyrtar të të pandehurve, gjykata shtyu seancën për në 30 prill. Në Shqipëri, i vetmi nga grupi është Armand Koçerri, i cili u arrestua së bashku me Nazer Seitin, ky i fundit, u ekstradua disa muaj më parë në Itali, ku edhe është duke u gjykuar. Prokuroria akuzon 9 të pandehurit, se në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, kanë trafikuar tonelata drogë drejt Italisë. Kujtojmë se nga përgjimet për këtë grup, ka dalë edhe emri i ish-ministrit Saimir Tahiri, i cili është marrë i pandehur për përkrahjen e grupit të Habilajve. I drejtuar nga kushërinjtë e tij Moisi dhe Artan Habilaj.

SHKURT

Grabitet banesa, avokati Edmond Saliu: Më morën në kasafortë 35 mln lekë

DURRËS - Persona ende të paidentifikuar kanë vjedhur banesën e avokatit Edmond Saliu në Durrës. Saliu ka deklaruar në polici se i janë vjedhur 350 milionë lekë të vjetra. Ngjarja ka ndodhur para disa ditësh, por vetëm dhe është bërë publike. Mësohet se autorët ende të paidentifikuar kanë marrë kasafortën, e cila mbahej e mbyllur me çelës. Policia, menjëherë sapo ka marrë denoncimin, ka nisur hetimin e ngjarjes. Ngjarja është kualifikuar si "vjedhje banese". Gjatë vjedhjes, nuk ka pasur asnjë thyerje të dritareve apo dyerve të banesës. Policia dyshon se vjedhja mund të jetë kryer nga persona të afërm të familjes. Uniformat blu thanë se këto dyshime shtohen, për shkak se autorët nuk kanë përdorur dhunë në banesë. Policia bëri me dije se dyshohet që autorët kanë hyrë në çelës, kanë marrë kasafortën me lekë dhe më pas janë larguar. Edmond Saliu është një avokat i njohur në Durrës, pasi ka mbrojtur disa çështje. Ai ishte njëri nga dy avokatët që mbrojtën dy vëllezërit Ekonom, të cilët u akuzuan se rrahën për vdekje 60-vjeçarën Agim Arapi, dosje në të cilin ishte i përfshirë edhe Jurgen Kurti, që u vra pak javë më parë në Tiranë.

Hajdutët u futën në banesën e 2 të moshuarve, u marrin pensionin

FIER - Në mes të ditës së djeshme është vjedhur një banesë në Peshtan të Fierit. Mësohet se autorët kanë hyrë nga dritaria në banesën e shtetasit me inicialet L.F. 66 vjeç dhe kanë arritur të marrin një sasi prej rreth 500 mijë lekësh të vjetra dhe disa sende me vlerë. Sipas policisë, hajdutët kanë shfrytëzuar orarin kur dy bashkëshortët nuk kanë qenë në shtëpi, pasi ata ishin duke punuar bahçen. Po si bluve, autorët kanë vjedhur lekë të pensionit mujor të dy të moshuarve. Këta dy të fundit kanë denoncuar në polici vjedhjen e parave, ndërsa policia punon intensivisht për identifikimin dhe kapjen e autorëve të krimit.

29-vjeçari i stërviste dy djemtë e tij në banesë si luftëtarë të ISIS

Arrestohet ish-komando i ushtrisë, Erzern Uka, për veprime terroriste

TIRANË

Ish-komando i ushtrisë, Erzern Uka, i cili ka shërbyer në Irak dhe Afganistan në vitin 2011 është arrestuar nga zyra Antiterrorit në Policinë e Shtetit. 29-vjeçari është vënë në pranga pas dyshimeve për prirje radikale dhe nxitjen e urrejtjes, me qëllim kryerjen e veprave terroriste. I arrestuari konsiderohet person me rrezikshmëri të lartë. Burime zyrtare nga policia dje bënë me dije se i riu me origjinë nga Kruja hotohej prej më shumë se dy vitësh nga Krimet e Rënda dhe se grupi hetimor drejtohet nga Eugen Beçi. Në kanal personal në "YouTube", ai ka postuar video ku shihen dy djemtë e tij të mitur duke u stërvitur. Gjithashtu, në video konstatohet që ish-komando stërvit në shtëpinë e tij një person se si mund t'i merrret nga dora arma kundërshtarit dhe neutralizimi i tij. Nga këqyrja e pro-



Ish-komando i ushtrisë, Erzern Uka

fileve në rrjetet sociale, ai është një mbështetës i Shtetit Islamik. Mësohet se Erzern Uka është divorcuar dhe është proceduar me parë për dhunë në familje. Pas divorcit, kujdestarinë e dy fëmijëve e fitoi ish-bashkëshortja, por vendimi i gjykatës nuk u zbatua. Mbi Ukën rëndon edhe akuzat e

stërvitjes për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste.

ARRESTIMI

"Specialistët e Drejtorisë së Antiterrorit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit pas një hetimi dyvjeçar me metoda speciale të hetimit, bënë arrestimin në flagrancë të shtetasit E. U., 29

vjeç, lindur në Gjorm, Krujë dhe banues në Tiranë, i proceduar më parë për veprat penale të 'Dhunës në familje' dhe 'Pengim të ekzekutimit të vendimit të gjykatës'. Ky shtetas në adresën e tij në "Facebook" ka publikuar dhe shpërndarë video pamje filmike që nxisin dhe propagandojnë veprat penale me qëllime terroriste", thuhet ndër të tjera në njoftimin zyrtar të Policisë së Shtetit. Ndërkaq, mësohet se gjatë kontrollit të banesës së tij, policia gjeti dhe sekuestroi në cilësinë e provës materiale një sasi fishkësh luftarakë. Materialet procedurale u referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda për veprat penale "Stërvitja për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste", "Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarakë dhe municionit".



Sekuestrohen 10.3 mln euro kokainë në Maltë, mediat: Shkonte në Shqipëri

MALTË - Departamenti i Doganave në Maltë ka sekuestruar një sasi prej 91.25 kg kokainë në portin e "Freeport". Mësohet se lënda narkotike me vlerë 10 milionë euro është gjetur në tre kontejnerë. Mësohet se operacioni që nisi të dielën e 14 prillit ka zgjatur më shumë se 19 orë dhe u finalizua mëngjesin e së hënës. Kokaina ishte e ndarë në tre kontejnerë të ndryshëm dhe në total u sekuestruan 76 pako, shkruan "independent.com.mt". Në orët e para të së dielës, njëسيا e monitorimit të kontejnerëve doganorë përzgjedhi disa kontejnerë për skanim. Pas skanimeve paraprake të marra nga ekipi i skanimit të Doganave, janë vërejtur parregullsi në tre kontejnerë. Kontrollat e imëtishme zbuluan se në të tri kishte pako me kokainë. Konkretisht, në kontejnerin e parë u zbuluan 20 pako kokainë, me peshë 24 kg, me një vlerë prej 2.7 milionë euro. Në kontejnerin e dytë ishin 40 pako me kokainë, me peshë 48 kg, me një vlerë prej 5.4 milionë eurosh. Në kontejnerin e tretë, zyrtarët doganorë gjetën 16 pako kokainë me peshë 19.25 kg dhe vlerë 2.2 milionë euro. Në total, 76 pako kokainë, me peshë 91.25 kg, me një vlerë prej 10.3 milionë euro. Sipas mediave vendase, kontejneri i parë dhe i tretë vinin nga Amerika e Jugut dhe do të kalonin transit në Maltë për në drejtim të portit të Durrësit, në Shqipëri. Ndërkohë që nuk është e qartë nëse Durrësi ka qenë destinacion përfundimtar. Ndërsa kontejneri i dytë, i cili gjithashtu vinte nga Amerika e Jugut, kalonte në portin maltez për të shkuar në Selanik, Greqi. Operacioni ishte rezultat i një bashkëpunimi midis punonjësve të Departamentit të Doganave, Policisë dhe "Malta Freeport". Çështja u mor në dorë nga skuadra antidroge e policisë, të cilët po kryejnë hetimet. Prokuroria po udhëheq hetimin e ndihmuar nga një ekip ekspertësh të policisë.



Implemented by **giz** German Development Cooperation

ProSEED: Announcement

Social Initiatives – Call for Expressions of Interest and submission of Proposals

The GIZ Program for "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" in Albania (GIZ ProSEED), implemented on behalf of the German Federal Ministry of Economic Cooperation and Development, under the component of Social Initiatives seeks in partnership with local CSOs to foster the inclusion perspectives of marginalized youth in employment and/or education. In this respect, the programme is conducting a Call for (i) Expressions of Interest and (ii) submission of project Proposals from **19 April – 10 May 2019** at giz-albanien@giz.de. The proposals that are to be selected through this call shall receive financial support ranging up to 50,000 EURO (equivalent in ALL).

Main Steps of the Procedure:

First step: (i) Expressions of Interest

All interested CSO at least with 2 years of experience implementing projects in the field of youth empowerment shall write to giz-albanien@giz.de, with the following text:

"We herewith declare our interest to participate in the 3rd Call for Proposals, organized by the GIZ ProSEED programme under the Social Initiatives Component. Please send us the respective Application Package".

Second Step: (ii) Submission of Application.

Upon receipt of the application package the CSO should consult the Application Guidelines to prepare their project proposals for all related eligibility criteria. The Application Guidelines (a separate document) can be downloaded from the ProSEED Facebook page. Deadline for the submission of application is **10 of May 2019**.

The application package must be submitted electronically in English at giz-albanien@giz.de. Applications submitted in hardcopies shall not be taken into consideration.

(Applying CSOs must take care to submit the budget in excel as a separate template and not merge it with the project description).

Third Step: (iii) Assessment and Evaluation of Proposals

Upon submission of the proposals by the CSOs the assessment and evaluation procedure shall be implemented as described in the Application Guidelines. For more information and the timeline of procedure please consult the Application Guidelines of this 3rd Call for Proposals.

Please, send an email to giz-albanien@giz.de, to express your interest and receive the application package.

For further questions contact us via email to giz-albanien@giz.de during the period **19 April – 10 May 2019**.



PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Njofton se duke filluar nga data 16 Prill 2019 çmimi maksimal i shitjes me pakicë për 1 paketë për produktet e mëposhtme të duhanit me ngrohje është si vijon:

Nr	Përshkrimi i Produktit	Çmimi prej datës 16.04.2019 (përfshirë TVSh-në)
1	HEETS (SILVER LABEL)	320 Lekë/ paketë

Njoftimi bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 28.1.2010 të Ministrisë së Financave "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" (i ndryshuar).

PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Rr. Murat Toptani , Qendra e biznesit Eurocol, Kati i 10,
1000 Tirana, Albania
Tel: +355 42 276 670

PEZULLIMI I REKTORIT PRENOCIMET

Dy ditë pas pezullimit nga detyra, reagoi kreu i Universitetit të Tiranës

Letra/Pezullimi si rektor, Mynyr Koni kërkon ndihmën e Metës

"Shpreh gatishmërinë time për çdo sqarim që ju duhet"

Mynyr Koni reagon pasi u pezullua nga detyra e rektorit të Universitetit të Tiranës. Ai thotë se një gjë të tillë e priste "pas gjithë atyre sulmeve të pashembullta që prej shumë kohësh janë adresuar ndaj personit tim", ndërsa shton se para se të merrte këtë vendim, Shahini duhet minimalisht ta kishte pritur në një takim. Ai thotë ndër të tjera se pezullimi i tij është kërkuar nga qeveria e Ramës, prandaj i kërkon Presidentit të Republikës së Shqipërisë, "që me seriozitetin dhe gjaktohtësinë që e karakterizon, ta shikojë me shumë kujdes këtë rast, jo për Mynyr Konin, por për Universitetin e Tiranës, për vetë rëndësinë, historinë dhe domethënien që ka ai në arsimin e lartë në vend". Koni shkon më tej duke thënë: "Dua të shpreh gatishmërinë time për çdo sqarim me institucionin e Presidentit, në lidhje me këtë çështje kaq delikate dhe të rëndësishme dhe mbetem i gatshëm për të vënë në dispozicion çdo dokument zyrtar që unë disponoj".

LETRA E PLOTË

Ashtu sikurse e citova edhe në deklaratën time të shkurtër në rrjetin social në "Facebook", pasi mësova nga media se ministria e Arsimit kishte vendosur pezullimin tim nga detyra e rektorit të Universitetit të Tiranës dhe i kishte kërkuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë shkarkimin tim, edhe një herë dua të theksoj me forcë se ministria aktuale e Arsimit, përpara se të merrte një vendim të tillë, do të thosha ekstrem dhe aspak të mbështetur në fakte dhe prova, në asnjë çast dhe në asnjë moment nuk më ka mundësuar një takim apo të më kishte dëgjuar se çfarë po ndodhte në të vërtetë në Universitetin e Tiranës dhe sesi prej vitesh, ky vendim ishte inkonsulent, ideuar, duke shfrytëzuar pothuajse të gjitha institucionet e shtetit shqiptar dhe duke përdorur apo detyruar në mënyrë me skandaloz drejtuesit e tyre, sikurse u vërtetua katërcipërisht edhe në rastin e vendimit më të fundit të ministres aktuale të Arsimit. Në fakt, ndëj detyrim moral për të bërë këtë deklaratë dhe për të sqaruar edhe një herë, sado pak qoftë, të gjithë ata që duan të dëgjojnë apo të kuptojnë të vërtetën; të gjithë ata që u "dhem" me të vërtetë Universiteti i Tiranës, kolegët dhe studentët e UT, por së pari, familjen time dhe bashkëpunëtorët e mi, që më kanë mbështetur në këtë rrugëtim të vështirë, që ka filluar që nga momenti i marrjes së detyrës si rektor i Universitetit të Tiranës. Në fakt, ishte e pritshme nga ana ime që situata do të shkronte deri këtu, pas gjithë atyre sulmeve të pashembullta që prej shumë kohësh, janë adresuar



Rекtor i UT-së, Mynyr Koni


ndaj personit tim. Deklaratën e saj, ministria e fillon me protestën e studentëve, pastaj vazhdon me ligjin e arsimit të lartë 80/2015 dhe risitë që paskërka sjell ky ligj; tek zbatimi i ligjit të shprehur në mënyrë të përsëritur, i kam kërkuar të shprehur në mënyrë institucionale dhe kam kërkuar ndërhyrjen e saj për çështje mjaft të rëndësishme për Universitetin e Tiranës, duke theksuar se: "... Rektorin i Universitetit të Tiranës nuk është mjaftuar vetëm me kompetencat akademike, por ka synuar edhe kompetencat administrative...". dhe vazhdon dhe flet e flet, por pa thënë asgjë konkrete dhe asgjë të provuar, por vetëm duke kryer detyrën dhe porosinë që ka marrë dhe që me patjetër, duhet ta përfundojë atë... Sikurse e kam thënë, përpara se të merrte një vendim të tillë, minimalisht, ministria duhet të më kishte dëgjuar, por siç duket, e tremb e vërteta, sepse sikurse edhe vetë e deklaroi, institucioni i rektorit dhe sidomos ai i rektorit të Universitetit të Tiranës është një institucion jo vetëm i rëndësishëm për arsimin e lartë, por është një institucion që del nga zgjedhjet dhe nga votat e më shumë se 25 mijë votuesve. Dhe kjo është mjaft e rëndësishme për shumë arsye dhe nënkupton dhe shumë gjëra, sidomos atë që artikullohet edhe më shumë sot ... "autonomia e IAL-ve". Që prej emërimit të saj si ministre, pavarësisht se ajo ka qenë pjesë e drejtimt të MASR dhe besoj se shumë gjëra mund t'i ketë dëgjuar, po sigurisht varet sesi dhe çfarë ka dëgjuar; kishin detyrimin institucional t'u kthente përgjigje shkresave

dhe kërkesave zyrtare që i kam përcjellë dhe ato nuk janë të pakta në kaq javë që ajo është në këtë detyrë. Kështu, në mënyrë të përsëritur, i kam kërkuar të shprehur në mënyrë institucionale dhe kam kërkuar ndërhyrjen e saj për çështje mjaft të rëndësishme për Universitetin e Tiranës, siç është zgjedhja e Komisionit të Përhershëm në nivelin e kryesore për marrjen e gradës shkencore "Doktor"; apo zbatimin i VKM nr:782 datë 26.12.2019 për zgjedhjen e anëtarit të Bordit të Administrimit të UT-së, nga studentët; e kam vënë në dijeni zyrtarisht për shkeljet ligjore nga ana e dekanëve të disa fakulteteve të UT-së, të cilët nuk kishin zbatuar detyrimin ligjor për të përcjellë të dhënat e kërkuara për hedhjen e tyre në portal apo për bibliotekën online, që aq shumë është përfolur kohët e fundit dhe për të cilën jam akuzuar unë sikur jam arsyeja e mosvënjes së saj në punë etj., etj... Dhe të gjitha këto janë me prova dhe fakte konkrete. Por, në asnjë rast kjo ministre nuk ka denjuar të kthejë as përgjigje dhe as të ndërhyjë apo të shprehë qëndrimin e saj institucionale. Ajo ka zgjedhur të heshtë dhe tashmë është e kuptueshme që me heshtjen e saj ka "gatuar" dhe ka përgatitur vendimin e pezullimit tim. Atëherë përse çuditërisht ministria, që unë nuk i kam përcjellë një propozim konkret për masë disiplinore për ndonjë nga dekanët, kur ajo kishte një sjellje të tillë; kur ajo nuk kishte dhe nuk tregonte asnjë frymë bashkëpunimi apo

bashkëpunimi të punëve me Rektorin e UT, gjithmonë në të mirë të institucionit dhe në zbatim të ligjit; kur ajo dilte hapur në mbrojtje të tyre; kur ajo vetë organizonte takime me këta dekanë dhe rektorin i Universitetit nuk ishte askund dhe nuk ftohej, por vetëm fajësohej, fajësohej prej saj dhe prej kryeministrit? Sigurisht që nuk mund të përcjilla tek ministria një propozim të tillë. Për më tepër; dua të theksoj se statuti i UT-së, i miratuar nga ministria e Arsimit, nuk i ka lënë asnjë kompetencë rektorit për ta bërë këtë gjë, dhe jo vetëm për dekanët, por edhe për personelin tjetër të UT-së, pavarësisht se rektorin është punëdhënësi dhe nënshkruan kontratat e punës me ta. Siç duket, për këtë arsye është miratuar në këtë mënyrë statuti i UT-së! Por, ju siguroj se në cilësinë e rektorit dhe të detyrimit ligjor dhe moral ndaj institucionit, të gjitha shkeljet ligjore të disa dekanëve, të ish-autoriteteve apo autoriteteve të tjera të UT-së i kam kallëzuar me prova dhe fakte konkrete në prokurori dhe aktualisht ndodhen në hetim për këto veprime. Por, le të ndalem pak tek inspektimi që përmend ministria në muajin shkurt 2018 nga një grup inspektimi i MASR, për vlerësimin e zbatimit të ligjshëm të organit drejtues të UT-së, i cili në përfundim të tij ka lënë 14 rekomandime për autoritetet dhe organet drejtuese të UT dhe se sipas ministres, vetëm rektorin nuk i paskërka zbatuar ato. Sapo është përcjellë raporti nga ish-ministria, pas analizimit të rekomandimeve të lëna për rektorin (gjithsej 6 prej tyre), me shkresë zyrtare i jam drejtuar ish-ministres duke i raportuar në lidhje me masat që ishin marrë dhe/ose ishin në proces zbatimi. Nuk kam pranuar të zbatoj vetëm ato rekomandime të cilat binin në kundërshtim të hapur me ligjin dhe për të cilat gjykatat kishin vendosur vlefshmërinë e tyre. Pikërisht për këto vendime, grupi i punës kishte rekomanduar shfuqizimin e tyre nga rektorin si të nxjerra jashtë kompetencave. Për këto kam bërë me dije ish-ministren si edhe grupin e punës

gjatë verifikimit prej tyre të zbatimit të rekomandimeve në vjeshtën e vitit 2018. Më vjen shumë keq, pasi nuk është as në edukatën dhe as në natyrën time, por më duhet të them se ministria jo vetëm tjetërson të vërtetën, por edhe mashtron në lidhje me këto fakte. Edhe pse i kemi dërguar mbi 50 faqe objeksione si dhe prova e fakte që vërtetojnë se anëtarët e inspektimit kanë shkelur rëndë ligjin, ministria vazhdon të dezinformojë opinionin publik me gjëra të pavërteta. Universiteti i Tiranës i ka kallëzuar në prokurori të gjithë anëtarët e inspektimit për shpërdorim detyre, mashtrim të fakteve, të kryera prej tyre në konflikt të hapur interesi. Ata, në çdo analizë dhe interpretim të çështjeve që kanë trajtuar në raport, i kanë justifikuar Bordit të Administrimit të Universitetit të Tiranës dhe Administrimit të këtij universiteti çdo shkelje ligjore dhe u kanë njohur si të drejta çdo tejkalim kompetence. Përse e bënin këtë? Sepse ata ishin vetë anëtarë përfaqësues të Ministrisë së Arsimit në Bordet e Administrimit në universitete të tjera publike dhe në këtë mënyrë u paraprinë justifikimit të shkeljeve ligjore që mund të kishin bërë apo që bënin në universitetet ku ato ishin emëruar si anëtarë të Bordeve të Administrimit. Të gjithë anëtarët e grupit të inspektimit prej një kohe të gjatë janë persona nën hetim pikërisht për hartimin e këtij raporti, të cilin ministria e ligjorën duke vendosur pezullimin tim. Kështu, ministria citon se rektorin i është kërkuar të shfuqizojë vendimet që ka marrë në tejkalim të kompetencave të tij ligjore. Pyetja ime është: Për cilat vendime e ka fjalën kjo ministre? Për të cilat vendime të cilat janë konstatuar të vlefshme nga gjykatat kompetente? Ministria citon se rektorin i është kërkuar të mospengojë punësimin e stafit akademik sipas nevojave të fakulteteve, duke përmendur se edhe sot ka akoma raste të tilla... dhe pyetja ime direkte është: Për cilat raste e ka fjalën zonia ministre, për të gjitha ato raste që kërkohet të shkelet dhe të moszbatohet as ligji dhe as aktet nënligjore në

fuqi në lidhje me rekrutimet? Nëse do të kishte denjuar dhe do të kishte lexuar sado pak objeksionet ndaj projekt-raportit apo të shikonte korrespondencën që kam pasur me dekanët e disa fakulteteve në lidhje me këtë çështje, absolutisht që nuk do ta përmendte si një nga "arsyet" absurde për pezullimin tim nga detyra, por për kundrazin... Por, sigurisht që nuk e ka bërë... Përse në disa fakultete dhe njësi të tjera të UT, rekrutimet e personelit akademik janë zhvilluar normalisht, në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi, bazuar në nevojat dhe kërkesat e tyre? Si e shpjegoni ju këtë gjë zonia ministre? Përse unë si rektor duhet të pengoj disa rekrutime dhe shumë të tjera t'i lejoja të bëheshin? Kjo është e pakuptimë nga ana ime... Sigurisht, edhe për ju dhe për të gjithë, por kështu duhet të thuhet nga ana juaj... sepse kështu është porosia... Asgjë nuk është penguar nga ana ime, asgjë nuk është "paralizuar", por përkundrazi, kështu kanë dashur të veprojnë dekanët e disa fakulteteve, sepse kështu bëhet "arsye e fortë" për pezullimin e rektorit. Ministria flet për bllokim nga ana e rektorit të protokoll-arshivës të institucionit... pa u ndalur në këtë çështje, sepse ndoshta ky është edhe rasti më tipik, më i qartë dhe më flagrant sesi janë përdorur institucionet e shtetit shqiptar dhe drejtuesit e tyre për të "luftuar" Rektorin e UT-së, në këtë rast do të doja të bëja vetëm një pyetje: Ju zonia ministre sa protokolle dhe vula zyrtare keni në institucionin që drejtoni? Çfarë do të bënit ju nëse në institucionin që drejtoni ka më shumë se një vullë zyrtare dhe më shumë se një protokoll zyrtar? Edhe për këtë rast, gjykata ka vendosur në favor të rektorit, duke shfuqizuar vendimet e gjogave të vendosura nga drejtori i përgjithshëm i Arkivave (edhe ky, drejtues i porositur i qeverisë). Ministria citon që rektorin të UT-së i është kërkuar urgjentisht funksionimi i sistemit informativ i universitetit... dhe sipas saj, "kjo është një shkelje e rëndë, por edhe banale... se po flasim për vitin 2019...". Sigurisht që →





Besa Shahini: Duhet të ndërmerre masa për të përmirësuar klimën e punës në universitet, kjo s'ndodhi

Ministria zëvendëson rektorin Mynyr Koni

Katër dekanë në një mendje me shefen e Arsimit: Abuzonte me detyrën

← është një shkelje e rëndë dhe banale, por ministria në këtë rast i ngatërron vetë kompetencat e rektorit me ato të administratorit...

Mos i duket ministres se funksionimi i sistemit është një kompetencë akademike? Nuk e di ministria që të funksionojë sistemi informatik kërkohet një procedurë prokurimi dhe tenderimi... Apo tenderat në këtë rast duhet t'i zhvillojë rektorin... Edhe në rekomandimet e grupit të punës, (rekomandimi 3) Administratori i UT-së brenda muajit shtator 2018 ka përgjegjësinë institucionale për të vendosur në funksion të plotë sistemet informatike të Universitetit të Tiranës, në zbatim të rregullores "Për funksionimin e sistemit informatik në Universitetin e Tiranës" miratuar nga rektori me nr. 317/1, datë 31.03.2014. Çfarë është kjo zonja ministre, një ngatërrës rastësore apo kështu duhet thënë? ...Në këtë mënyrë bëhet një "arsye tjetër e fortë" për të pezulluar rektorin... Dhe sipas ministres, mosfunksionimi i sistemit informatik paskërka penguar nisat e qeverisë në kuadrin e Paktit për Universitetin (bursat, biblioteka dixhitale...), gjë që nuk është aspak e vërtetë... Kushdo që merr vesh sado pak nga teknologjia (dhe meqenëse është viti 2019, janë shumë në fakt), e kuptojnë se këto nuk kanë asnjë lidhje me njëra-tjetër... Ministres i ka bërë përshtypje "mungesa e iniciativës" së rektorit për të zgjidhur situatën... zonja ministre, si keni arritur në këtë konkluzion? Çfarë duhet të bënte më shumë rektori sesa të njoftonte dhe të kërkonte mirëkuptimin dhe mbështetjen e institucioneve më të larta të shtetit shqiptar? Dhe jo kur u ngritën studentët në protestë dhe qeveria dhe MASR "të kuptonin" se çfarë po ndodhte... Por, shumë kohë më parë sesa studentët të ngriheshin në protesta. Por fatkeqësisht, çfarë ndodhi? Institucionet jo vetëm që nuk reagojnë, por përkundrazi, ato mbështeten dhe përkrahin paligjshmërinë e dekanëve në disa fakultete të UT-së, të ish-

kancelarit, të Bordit të Administratorit dhe të administratorit të institucionit. Dhe këtë e them me përgjegjësi të plotë. Nuk ishte e nevojshme që të ngriheshin studentët dhe të artikulonin kërkesat e tyre që unë të kuptoja se çfarë po ndodhte. Siç e thashë edhe më lart, unë kisha kohë që në detyrim të ligjit dhe të atyre që më kishin zgjedhur për të drejtuar institucionin, kisha informuar të gjitha institucionet e shtetit shqiptar dhe isha përpjekur në mënyrë të vazhdueshme, me shkresa dhe komunikime zyrtare, të përsëritura, duke shpjeguar konkretisht, me nene dhe ligje të caktuara, shkeljet flagrante të ligjit nga ana e disa dekanëve apo të ish-kancelarit, të Bordit të Administratorit apo të administratorit aktual të institucionit. Ministria citon se nuk ka asnjë gjë tjetër në dorë për të zgjidhur ngërçin në Universitetin e Tiranës, përveçse të pezullojë rektorin e UT dhe të kërkojë nga Presidenti i Republikës shkarkimin e tij...Dhe kjo... për t'i hapur rrugë reformës në UT. Për cilën reformë e ka fjalën ministria? Shkarkimi i rektorit ia mundëson këtë ministres dhe qeverisë së saj? Apo rektori duke zbatuar ligjet, i ka penguar për të bërë atë çfarë prej kohësh duan të bëjnë me këtë institucion? Dhe në fund, ministria mundohet ta mbyllë "bukur" deklaratën, me fjali të mëdha, pompoze, ashtu sikurse e ka aftësi qeveria e saj... Tregon se çfarë do të bëjnë për universitetet, tregon se çfarë duhet të bëjë një universitet për studentët e tij dhe se me çfarë dimesh dhe aftësish duhet t'i përgatisë ata etj., etj... Dhe ministres i duhet një frymë e re bashkëpunimi... pa Mynyr Konin... sepse me të është e pamundur... Dhe ministria citon se është e detyruar të marrë një vendim kaq të vështirë... nga kush është e detyruar, për çfarë arsye? Por të gjitha janë të kuptueshme, janë fare të qarta, jo vetëm nga ana ime, por tashmë nga të gjithë. Sulmet e vazhdueshme në media, vend e pa vend, pa asnjë arsye dhe fakt, të kryeministrit dhe tashmë të ministres, nuk janë gjë tjetër veçse përfundimi i një skenari të

Dy ditë pas pezullimit të Rektorit, Mynyr Koni, 4 dekanët e fakulteteve të Universitetit të Tiranës në një deklaratë për media vlerësojnë vendimin e ministres së Arsimit, Besa Shahini. Ata shprehën se vendimi është eficient dhe zëvendësimi i tij do t'i hapë rrugë funksionimit pozitiv të Universitetit. Po dhe ministria e Arsimit komandoi në vend të Konit, Bernard Dostin, zv/Rektorin e Universitetit të Tiranës ndërsa do i kërkojë presidentit Ilir Meta shkarkimin e Rektorit të pezulluar.

DEKLARATAT

Dhori Kule, Dekan i Fakultetit Ekonomik tha se janë bërë prezente shkeljet shumë flagrante të Mynyr Konit që lidhen me shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit. "Administratori e Universitetit të Tiranës ka ezauruar 80 lëvizje jashtë vendit kur në një fakultet ka pasur vetëm 4 të nevojshme. Këto ditë të gjithë thonë se veprimi është i mirëpritur, por e konsiderojnë shumë të vonuar reagimin e ministrisë. Situatat do të jetë shumë pozitive tani e tutje. Pedagogët dhe studentët



Ministria e Arsimit, Besa Shahini

do të shohin se sa e lehtë është se kur institucioni që mëson të tjerët sesi të sillen, do sillen vetë mirë. Këtyrë ngërçi që përfundoi tani do i ndihet lezeti. Do të kemi vetëm progres dhe ecuri pozitive dhe një angazhim për të kompensuar të gjitha këto deficienca që kemi pasur gjatë kësa përiudhe", u shpreh Kule. Të njëjtin qëndrim pati dhe dekan i Fakultetit Juridik, Artan Hoxha, i cili tha se Koni ka abuzuar me detyrën. "Është e vonuar Ministria e Arsimit në nxjerrjen e këtyre rezultateve, por populli thotë më

mirë vonë se kurrë. Ajo që ka kërkuar ministria në vlerësojmë dhe është në përputhje me Autonominë Universitare. Janë kryer veprime të hapura në kundërshtim me ligjin", tha Hoxha.

KËRKESË PRESIDENTIT

Ministria e Arsimit i kërkon Presidentit Meta, shkarkimin e Rektorit të Universitetit të Tiranës, Mynyr Koni. Ministria Besa Shahini tha se institucioni që ajo drejton ka vendosur pezullimin e Rektorit Koni, ndërsa tha se i është drejtuar me kërkesë kreut

të shtetit për shkarkimin e tij. "Më ka bërë përshtypje mungesa e iniciativës së rektorit për të zgjidhur problemet në universitet. Rektori është ankuar shpesh për dekanët, por kurrë nuk ka ardhur me një kërkesë të mirë-argumentuar që t'ia aprovojim heqjen e tyre. Shpresova se do të shfrytëzonte momentin e krijuar nga protesta e studentëve për të ndërmarrë masa dhe përmirësuar klimën e punës në universitet, por kjo nuk ndodhi", tha ministria. "Më vjen me të vërtetë keq për profesor Konin, i cili ka qenë gjithmonë shumë korrekt dhe kordial me mua si person. Por, përkundër kordialitetit, jam udhëheqëse e një institucioni që ka për detyrë të sigurohet se ligji po zbatohet dhe reforma po realizohet në të mirë të të gjithëve. Sidoqoftë, është gjithmonë vështirë të merret vendim për pezullimin e një personi të zgjedhur me vota nga institucioni që përfaqëson dhe më vjen keq që kemi arritur deri këtu"-shtoi Shahini. Vendimin për shkarkimin e rektorit e merr presidenti, i cili duhet të vlerësojë ligjshmërinë e kërkesës së ministres së Arsimit.

shkruar, ideuar, instrumentuar dhe drejtuar nga vetë qeveria. Kariërinë time akademike, fatmirësisht, nuk e kam të lidhur as me karrigen e rektorit dhe as me të qenurit rektor. Në jetën time jam edukuar dhe formuar të jem njeri i drejtë, parimor dhe me principe dhe i tillë do të vazhdoj të mbetem. Nëpërmjet kësaj deklaratë, dua t'i kërkoj Presidentit të Republikës së Shqipërisë, që me seriozitetin dhe gjakftohtësinë që e karakterizon, ta shikojë me shumë kujdes këtë rast, jo për Mynyr Konin, por për Universitetin e Tiranës, për vetë rëndësinë, historinë dhe domethënieën që ka ai në arsimin e lartë në vend. Gjithashtu, dua të shpreh gatishtërinë time për çdo sqarim me institucionin e Presidentit në lidhje me këtë çështje kaq delikate dhe të rëndësishme dhe mbetem i gatshëm për të vënë në dispozicion çdo dokument zyrtar që unë disponoj.

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E BRENDSHME
SHËRBIIMI PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT

"Për Shpalljen e funksioneve të lira për konkurrim në strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme." Në mbështetje të neneve 3 pika a, 21, nenit 70 e vijues, nenit 76 e vijues të Ligjit Nr.70/2014 "Për Shërbimin Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme si dhe bazuar në Urdhryn Nr. 579, datë 26.10.2018, " Mbi miratimin e Strukturës dhe Organizatës të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme si dhe nenet 55 e vijues të Rregullores së Shërbimit Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, miratuar me Vendim Nr. 829 , datë 03.12.2014 , të Këshillit të Ministrave.

URDHËROJ:

- Shpalljen e funksioneve të lira për konkurrim në strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat si më poshtë:
- (dy) funksione organike, Drejtor Drejtorie në Drejtoritë Rajonale të SH.Ç.B.A-së, me gradën e Shërbimit (Drejtuës / Drejtues / Parë).
- (tre) funksione organike, Shef Sektori Hetimi në Drejtoritë Rajonale të SH.Ç.B.A-së, me gradën e Shërbimit (Kryeinspektor / Drejtues).
- (katër) funksione organike, Specialist Hetimi në Drejtoritë Rajonale të SH.Ç.B.A-së, me gradën e Shërbimit (Inspektor / Inspektor i Parë).
- (dy) funksione organike, Specialist në Drejtoritë Qendër të SH.Ç.B.A-së, me gradën e Shërbimit (Kryeinspektor) Përpas kritereve të përgjithshme, kandidatit duhet të plotësojë:
- Arsimi i lartë Policor ose "Master i Shkencave" në Drejtësi.
- Punonjësi para se të pranohet në Shërbim, në strukturat hetimore e operationale, duhet të kenë përvojë pune jo më pak se 3 (tre) vjet dhe vlerësime të larta në punë, në këto struktura të ngjashme me Shërbimin, sipas përcaktimeve ligjore.
- Të ketë njohuri të mira gjuhës së huaj, preferohen gjuhët e BE-së.
- Të mos jetë marrë masa disiplinore e përjashtimi nga detyra shtetërore gjatë shtatë viteve të fundit .
- Të mos ketë marrë asnjë masë disiplinore gjatë vitit të fundit.
- Të njohë dhe përdorë programet bazë të punës në kompjuter.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese në të folur e të shkruar.
- Të jetë i gatshëm të caktohet me shërbim kudo, sipas strukturës së Shërbimit brenda territorit të vendit. Periudha e aplikimit fillon me datë 17.04.2019 dhe përfundon me datë 26.04.2019.

Për më shumë informacion drejtoheni në faqen zyrtare www.shcba.gov.al.

RRITJA E PAGAVE

TABELAT PER ÇDO KATEGORI

Si ndryshojnë pagat e drejtorëve të shkollave, mësuesve dhe edukatoreve

Zbardhen tabelat, rritjet e pagave për mësuesit, kush përfiton 5-20%

Sa shkon rroga e ambasadorëve dhe e ndihmëseve të tyre

Zbardhen tabelat me rritjen e pagës për mësuesit, edukatorët, drejtorët e shkollave, ushtarakët sipas gradave, policët e burgjeve, diplomatët e përfaqësuesit dhe Shqipërisë në NATO. Rritja e pagave fillon 2% dhe shkon deri në 20%. Në Fletoren Zyrtare janë publikuar dhe tabelat për çdo kategori. Kështu, për kushte të veçanta pune e shërbimi ushtarak aktivë në Forcat e Armatosura përfitojnë rritje page nga 3 mijë lekë në muaj për gradën më të ulët, në 15 mijë lekë në muaj për gradën më të lartë. Ndërkohë, struktura e pagës për punonjësit mësimorë dhe drejtuesit e institucioneve të arsimit parashkollor, të qendrave kulturore të fëmijëve dhe konvikteve të nxënësve, shtesa për vjetërsi është 2% dhe shtesa për kualifikimin është 5% deri në 20%. Në total do të përfitojnë rritje page 65 mijë punonjës buxhetorë me një fond prej 3 miliardë lekësh.

DIPLOMATËT

Qeveria ka miratuar pagat e reja për trupën diplomatike. Përfaqësuesit e Shqipërisë nëpër botë marrin paga nga 1680 euro, që është rroga e ambasadorit duke

RRITJE ME 7%

- 36 mijë mësues të arsimit parashkollor, arsimit bazë, arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe atij profesional.
- 4.650 mjekë, 13.765 infermierë dhe staf shëndetësor.
- 6,800 ushtarakë.

RRITJE 7-20%

- 3.560 punonjës të sistemit penitenciar (Policia e Burgjeve).
- 308 punonjës të përfaqësive diplomatike jashtë vendit.

PËRFITUESIT

- 65 mijë punonjës buxhetorë përfitojnë rritje page.
- 3 miliardë lekë është fondi i vënë në dispozicion për rritjen e pagave.

zbritur në 570 euro, që është rroga e atasheut. Struktura e re e pagave i shtrin efektet financiare nga 1 prilli i këtij vit dhe do të aplikohet për gjithë personelin që shërben jashtë vendit. Vendimi i qeverisë, të cilit i referohen edhe tabelat për çdo për-

fitues në vijim përcakton pagat dhe shtesat mbi pagë të punonjësve të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtete të huaja, të atasheve ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe personelit civil

të Ministrisë së Mbrojtjes, që shërbejnë në përfaqësitë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabete ushtarake ndërkombëtare. Përfitues të rritjes së pagave janë edhe punonjësit shqiptarë për kohën që shërbejnë si nëpunës ndërlidhës pranë qendrës Seci, të punonjësve shqiptarë për kohën që shërbejnë si oficerë kontakti, pranë Ministrive të Brendshme homologe të shteteve të ndryshme, të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë dhe të punonjësve të sekretariatit të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural për kohën që shërbejnë si përfaqësues të kësaj ministrie pranë misionit të Republikës së Shqipërisë në Bruksel". Qeveria ka parashikuar që efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për



Foto ilustruese

Albumi

SHITESAT

Struktura e pagës për punonjësit mësimorë dhe drejtuesit e institucioneve të arsimit parashkollor, të qendrave kulturore të fëmijëve dhe konvikteve të nxënësve, shtesa për vjetërsi është 2% dhe shtesa për kualifikimin është 5% deri në 20%. Në total do të përfitojnë rritje page 65 mijë punonjës buxhetorë me një fond prej 3 miliardë lekësh.

vitin 2019 të përballohen nga ministrinë përkatëse nga fondet e miratuara për këtë sistem për paga dhe sigurime shoqërore, si dhe nga fondet për politikën e reja të pagave, të miratuara në

ligjin nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019"; për të gjitha parashikimet e tjera, nga fondet e miratuara në ligjin nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", për politikën e reja të pagave.

Paga mujore e punonjësve të përcaktuar sipas pikës 1/3 të këtij vendimi

Emërtimi	Paga në euro	Paga në dollarë	Shtesa për përfaqësimin (në %)
Përfaqësitë NATO-s			
Gj. lejtant	1570	1900	75%
Gj. major	1540	1835	60-75%
Gj. brigade	1440	1725	60-75%
Përfaqësitë e tjera			
Kolonel	1290	1570	40-60%
Nënkolonel	1230	1475	40-60%
Major	1165	1410	40%
Kapiten	1080	1375	40%
Toger	1020	1245	40%
Nëntoger	945	1175	40%
K/kapiter	1020	1245	40%
Kapiter	915	1105	40%
Rreshter	780	915	40%
Tetar	635	775	40%
Nëntetar	570	700	40%

Paga mujore e punonjësve të përcaktuar sipas pikës 1/2 të këtij vendimi (në rastin kur janë të punësuar me kohë të plotë)

Pozicioni	PAGA MUJORE				
	Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3	Grupi 4	Grupi 5
Sekretar;	1105 euro	1055 euro	1005 euro	975 euro	905 euro
teknik;	1235 dollarë USD	1190 dollarë USD	1145 dollarë USD	1115 dollarë USD	1055 dollarë USD
financier;					
specialist					
Shofer	1055 euro	995 euro	945 euro	915 euro	845 euro
	1190 dollarë USD	1130 dollarë USD	1085 dollarë USD	1060 dollarë USD	990 dollarë USD
Kafaz	875 euro	830 euro	790 euro	750 euro	700 euro
	960 dollarë USD	925 dollarë USD	880 dollarë USD	845 dollarë USD	780 dollarë USD

Pagës mujore e punonjësve të përcaktuar sipas pikës 1/2 të këtij vendimi (në rastin kur janë të punësuar me kohë të pjeshme)

Pozicioni	PAGA MUJORE (me kohë të pjeshme)	
	Minimumi	Maksimumi
Sekretar teknik;	400 euro	610 euro
financier;	440 dollarë USD	680 dollarë USD
specialist		
Pastrues	310 euro	410 euro
	335 dollarë USD	455 dollarë USD

Paga mujore e punonjësve të përcaktuar sipas pikës 1/4 të këtij vendimi

Pozicioni	PAGA MUJORE	
	Paga bazë mujore (në euro dhe në dollarë)	Shtesa për përfaqësimin (në %)
Oficer kontakti;	1080 euro	40%
përfaqësues të sekretariatit të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural	1375 dollarë USD	

Struktura e pagës për punonjësit mësimorë dhe drejtues në institucionet arsimore, të përcaktuara në shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d", të pikës 1, të këtij vendimi

EMËRTIMI / POZICIONI	PAGA MUJORE				Shtesa e pozicionit
	Paga individuale			Shtesa për kualifikim (SHK)	
	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)		
1	2	3	4	5	
1. Drejtor i shkollës së mesme me mbi 700 nxënës. Drejtor i institutit të nxënësve që nuk shkojnë. Drejtor i institutit të nxënësve që nuk deqojnë. Drejtor në shkollat me aftësi të kufizuara.	1	2%	5% e PG; 10% e PG; 20% e PG.		61.000
2. Drejtor i shkollës së mesme me 301 deri në 700 nxënës.	1	2%	5% e PG; 10% e PG; 20% e PG.		59.750
3. Drejtor i shkollës së mesme me deri në 300 nxënës.	1	2%	5% e PG; 10% e PG; 20% e PG.		58.750
4. Zëvendës drejtor i shkollës së mesme me mbi 700 nxënës. Përgjegjës i bazës prodhuese. Zëvendës drejtor i institutit të nxënësve që nuk shkojnë. Zëvendës drejtor i institutit të nxënësve që nuk deqojnë. Zëvendës drejtor në shkollat me aftësi të kufizuara.	1	2%	5% e PG; 10% e PG; 20% e PG.		54.500
5. Zëvendës drejtor i shkollës së mesme me 301 deri në 700 nxënës.	1	2%	5% e PG; 10% e PG; 20% e PG.		53.500
6. Zëvendës drejtor i shkollës së mesme me deri në 300 nxënës.	1	2%	5% e PG; 10% e PG; 20% e PG.		52.750
7. Drejtor i shkollës 9-vjeçare me mbi 700 nxënës.	1	2%	5% e PG; 10% e PG; 20% e PG.		50.850
8. Drejtor i shkollës 9-vjeçare me 301 deri në 700 nxënës.	1	2%	5% e PG; 10% e PG; 20% e PG.		49.500

9. Drejtor i shkollës 9-vjeçare me deri në 300 nxënës.	1	2%	5% e PG; 10% e PG; 20% e PG.		48.500
10. Drejtor i shkollës fillore klasa I-IV. Përgjegjës (kryemësues) i shkollës me klasë kolektive. Zëvendës drejtor i shkollës 9-vjeçare.	1	2%	5% e PG; 10% e PG; 20% e PG.		48.000
11. Mësues në shkollat e mesme. Mësues në institutin e nxënësve që nuk shkojnë. Mësues në institutin e nxënësve që nuk deqojnë. Mësues në shkollat me aftësi të kufizuara. Mësues i praktikës profesionale.	1	2%	5% e PG; 10% e PG; 20% e PG.		45.000
12. Mësues në cilin e lartë në shkollat 9-vjeçare.	1	2%	5% e PG; 10% e PG; 20% e PG.		42.000
13. Mësues në cilin e ulët në shkollat 9-vjeçare.	1	2%	5% e PG; 10% e PG; 20% e PG.		39.300
14. Mësues në cilin e ulët në shkollat 9-vjeçare.	2	2%	5% e PG; 10% e PG; 20% e PG.		36.650
15. Mësues në cilin e ulët në shkollat 9-vjeçare. Instruktor i praktikës profesionale.	3				34.000

Lidhja nr. 3

Struktura e pagës për punonjësit mësimorë dhe drejtues të institucioneve të arsimi parashkollor, të qendrave kulturore të fëmijëve dhe konvikteve të nxënësve

EMËRTIMI / POZICIONI	PAGA MUJORE				Shtesa e Pozicionit
	Paga individuale			Shtesa për kualifikim (SHK)	
	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)		
1	2	3	4	5	
1. Drejtor i konvikteve.	1	2%	5% e PG; 10% e PG; 20% e PG.		61.000
2. Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijëve.	1	2%	5% e PG; 10% e PG; 20% e PG.		51.000
3. Drejtor i kopshtit me ushqim.	1	2%	5% e PG; 10% e PG; 20% e PG.		45.000
4. Përgjegjës sektori në Qendrën Kulturore të Fëmijëve.	1	2%	5% e PG; 10% e PG; 20% e PG.		44.000
5. Drejtor i kopshtit pa ushqim.	1	2%	5% e PG; 10% e PG; 20% e PG.		42.500
6. Instruktor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve.	1	2%	5% e PG; 10% e PG; 20% e PG.		42.500
7. Edukator konvakti. Kujdestar konvakti.	1	2%	5% e PG; 10% e PG;		39.300

Njoftim shitje me ankand

Shoqëria përbarimorë "AA Bailiff" shpk, zhvillon ankandin e III-të, për shitjen e pasurisë së paluajtshme, Trulli 310 m2 dhe ndërtesë 96 m2, me nr. pasurie 170/14, Vol. 8, Fq. 154, ZK. 3852, në pronësi të Ruzhidit Demir Tropinji e regjistruar në ZVRPP Durrës
Cmimi i ankandit të trete është EUR 21.600 (njëzetë e një mijë e gjashtëqind euro)
Ankandi zhvillohet dt. 10/05/2019, ora 16.00 në adresën Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27, Hyrja 1, Kati i III-të, Tiranë. Kontakt: cel. 0688012846, ose në adresën e email: aabailiff@gmail.com.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERBARIMORË GJYQESORË PRIVATE 'ILIA ELEZI'
Pasuria nr. 1/165+1-8/1, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 6, FAQE 179, SIPËRFAQE 57 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. PËLLUMB META DHE ZNJ. RITA META.
ÇMIMI 3.850.000 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 09.05.2019. CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza e trete , për shitjen e pasurisë së paluajtshme për të cilën ka venë hipoteke BKT BANK, me këto të dhëna:
Pasuria "ARË" nr. 175, Zona Kadastrale 3339, me sipërfaqe 7780 m² faqe 190 vol.5, e ndodhur në Vrin Durrës, në pronësi të z. Adrian Sefer Kapllani dt.08.03.1969, zj. Merta Myzeler Kapllani dt.24.06.1970
Në vlerën 7.308.000 (shtatë milion e treqind e tetë mijë) Lekë.
Pasuria Apartamenti me sip.120m2 nr.pas.41/150+1-1.26.8518 vol.116 fq.54 me adresë:Plazh/13 Durrës në pronësi të z.Adrian Sefer Kapllani dt.08.03.1969.
Në vlerën 3.390.569 (tre milion e treqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë.
Ankandi zhvillohet në datën 20.05.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbarimit gjyqësor me adresë Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë.

Paga mujore e punonjësve të përcaktuar sipas pikës 1/5 të këtij vendimi

Pozicioni	PAGA MUJORE	
	Paga bazë mujore (në euro)	Shtesa për përfaqësimin (në %)
Nëpunës ndërlidhës	1080 euro	40%

Masa e shtesës për kushte të veçanta pune e shërbimi për ushtarakët aktivë fluturues të Forcave të Armatosura

Nr.	Emërtimi i funksionit	Masa e shtesës mujore në lekë për muaj			
		Në skuadrone dhe grupe të helikopterëve në bazën ajrore Farkë të Forcave të Armatosura	Në strukturat e tjerat të bazës ajrore Farkë të Forcave të Armatosura	Në strukturat e tjerat të Forcave Ajrore	Në strukturat e tjerat të Forcave të Armatosura
1.	Pilot	60.000	30.000	20.000	10.000
2.	Inxhinier fluturimi	28.000	21.000	14.000	
3.	Mekanik/Teknik bordi	24.000	18.000	12.000	
4.	Infermier bordi Operator bordi	20.000	15.000	10.000	
5.	Inxhinier avioni/helikopteri	16.000	12.000	10.000	
6.	Kontrollor i trafikut ajror	12.000	12.000	12.000	
7.	Teknik avionic/helikopteri	12.000	10.000	10.000	

Masa e shtesës për kushte të veçanta pune e shërbimi që përfitojnë ushtarakët aktivë, të tjerë, në Forcat e Armatosura

Nr.	Niveli	Struktura/ Funksioni/Specialiteti - Ushtarakë të tjerë që përfitojnë shtesë për kushte të veçanta pune e shërbimi	Masa e shtesës, Lekë në muaj
			4
1.	1	Kompanitë e aksioneve direkte në Batalionin e Forcave Speciale në Forcën Tokësore	15.000
2.		Kompanitë Komando dhe Kompania e Zbulimit në Batalionin Komando të Forcës Tokësore	15.000
3.		Grupi Bordingut në Flotiljen Detare në Forcën Detare	15.000
4.		Grupi i Parë, i Dytë dhe Grupi AME i Zhytjeve në Qendrën e Zhytjeve në Forcën Detare	15.000
5.	2	Kompania EOD në Batalionin e Xhenjos në Komandën Mbështetëse	12.000
6.		Grupi i parë dhe i dytë i flotiljes detare në Flotiljen Detare në Forcën Detare	12.000
7.		Kompania e parë dhe e dytë Operacionale në Policinë Ushtarake të Forcave të Armatosura.	12.000
8.		Sektori i Policisë Kriminale në Policinë Ushtarake të Forcave të Armatosura	12.000
9.	3	Komandant, Zv.Komandant dhe Funksionet me specialitet "Polubar" në Qendrën e Zhytjeve në Forcën Detare	12.000
10.		Kompanitë në Batalionin e Parë të Këmborisë në Forcën Tokësore	10.000
11.		Kompanitë në Batalionin e Dytë të Këmborisë në Forcën Tokësore	10.000
12.	4	Kompanitë në Batalionin e Tretë të Këmborisë në Forcën Tokësore	10.000
13.		Orkestra Frymore në Batalionin e Mbështetjes së SHPPA	10.000
14.		Mjekët në Strukturat e Forcave të Armatosura	8.000
15.	5	Parashutistët në Strukturat e Forcave të Armatosura	8.000
16.		Funksione organike me detyra operacionale dhe taktike në Batalionin e Forcave Speciale në Forcën Tokësore	8.000
17.		Funksione organike me detyra operacionale dhe taktike në Batalionin Komando të Forcës Tokësore	8.000
18.		Kompania e Rruajtjes në Batalionin e Mbështetjes së SHPPA	8.000
19.		Kompania e Ceremonialit në Batalionin e Mbështetjes së SHPPA	8.000
20.		Grupi i Sigurisë Fizike në MM në Batalionin e Mbështetjes së SHPPA	8.000
21.		Kompania e Transportit në Batalionin e Mbështetjes së SHPPA	8.000
22.		Infermierët në Strukturat e Forcave të Armatosura	8.000
23.		Në strukturat e Policisë Ushtarake, të cilat angazhohen direkt në punën operative dhe funksionale që kryen Policia Ushtarake	8.000
24.		6	Funksione organike në Batalionin e Forcave Speciale në Forcën Tokësore të papërfshira në pikat e mësipërme
25.	Funksione organike në Batalionin Komando të Forcës Tokësore të papërfshira në pikat e mësipërme		5.000
26.	Qendrën e Stërvitjes Bazë, që janë të emëruar në funksione dhe që kryejnë direkt stërvitjen bazë		5.000
27.	Qendrën e Stërvitjes Bazë deri në nivel kompanie		5.000
28.	Strukturën e Rojes Bregdetare		5.000
29.	Në nivel kompanie në Forcën Tokësore		5.000
30.	Në Kursët në Akademinë e Nënoficerëve		5.000
31.	7	Oficerët me specialitete detare të emëruar në pozicione organike, që kërkojnë kryerjen e lundimeve	3.000
32.		Funksione organike në Policinë Ushtarake të pa përfshira në pikat e mësipërme	3.000
33.		Funksione organike në Forcën Tokësore të papërfshira në pikat e mësipërme	3.000
34.		Personeli ushtarak i Qendrës së Stërvitjes Bazë të papërfshirë në pikat e mësipërme	3.000
35.		Personeli ushtarak i postave radioteknike dhe postave sinjal-vrojtuese, në Forcat Detare	3.000
36.		Ushtarakë të tjerë në Akademinë e Nënoficerëve	3.000

RRITJA E PAGAVE

TABELAT PER ÇDO KATEGORI

PAGA BAZË SIPAS GRADËS DHE VITEVE TË SHËRBIMIT PËR USHTARAKËT AKTIVË TË FORCAVE TË ARMATOSURA

OFICERË	Vitet e shërbimit															
	P.bazë	Mbi 1 vit	Mbi 2 vjet	Mbi 3 vjet	Mbi 4 vjet	Mbi 6 vjet	Mbi 8 vjet	Mbi 10 vjet	Mbi 12 vjet	Mbi 14 vjet	Mbi 16 vjet	Mbi 18 vjet	Mbi 20 vjet	Mbi 22 vjet	Mbi 24 vjet	Mbi 26 vjet
Gj. lejtant (admiral)																169500
Gj. major (nëadmiral)																162000
Gj. brigade (kundëradmiral)																127500
Kolonel (kapiten i rangut I)														106200	108400	110000
Nënkolonel (kapiten i rangut II)												86700	88100	89500	90900	92300
Majror (kapiten i rangut III)									68800	70600	71800	73400	74500	75700	77500	78700
Kapiten (kapiten lejtant)						61500	62500	64000	65300	66000						
Toger (lejtant)				57800	58700	59800	61300	62000	63600	64800						
Nëntoger (nënlejtant)	55600	56000	56900	57800	58600	59000	60400									
NËNOFICERË	Vitet e shërbimit															
	Nën 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26	
K/kapiten											59500	60600	62500	63700	64800	
Kapiten								52500	53600	54700	55800	57000	58700	59800	60900	
Rreshter						48200	49400			53500	54500	55500				
Tetar						46700	47800	48300	49500							
Nëntetar				43700	44600	45700	46200	47200	48500							
USHTARË AKTIVË	Vitet e shërbimit															
	P.bazë	Mbi 1 vit	Mbi 2 vjet	Mbi 3 vjet	Mbi 4 vjet	Mbi 5 vjet	Mbi 6 vjet	Mbi 8 vjet	Mbi 10 vjet	Mbi 12 vjet	Mbi 14 vjet					
Ushtar IV/ detar IV			42000	42400	43000	43400	44000			45000	45900	47000	48000			
Ushtar III/ detar III			40900	41500												
Ushtar II/ detar II	40000	40500														
Ushtar I/ detar I	39300															

Paga mujore e punonjësve të përcaktuar sipas pikës 1/1 të këtij vendimi

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Burgjeve

Roli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi		
1	2	3	4	5	6
			Në funksione të Policisë së Regjimeve të Jashtme, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale	Në funksione të Policisë së Regjimeve të Brendshme dhe transferim-shoqërimet në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale	Në funksione të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve
Bazë	Nëninspektor	43.000	4.000	8.000	
	Inspektor	46.900	4.000	8.000	
	Kryeinspektor	52.700	4.000	8.000	2.000
I mesëm	Nënkomisar	64.000	4.000	8.000	2.000
	Komisar	69.000	4.000	8.000	2.000
	Kryekomisar	95.000	4.000	8.000	2.000
I lartë	Drejtuës	106.700			6.500
	Drejtuës I	111.000			15.000
Drejtor i Policisë së Burgjeve	Drejtor i Policisë së Burgjeve	115.000			

Pozicioni	PAGA MUJORE	
	1	2
	Paga bazë mujore (në euro dhe dollarë USD)	Shtesa për përfaqësimin (në %)
Ambasador	1680 euro 2045 dollarë USD	75%
Konsull i përgjithshëm; ministër fuqplotë; ministër këshilltar	1295 euro 1560 dollarë USD	75% 40% 40%
Këshilltar	1080 euro 1375 dollarë USD	40%
Sekretar i parë; konsull	895 euro 1095 dollarë USD	40%
Sekretar i dytë; zëvendeskonsull	700 euro 890 dollarë USD	40%
Sekretar i tretë; agjent konsull	635 euro 780 dollarë USD	40%
Atashe	570 euro 700 dollarë USD	40%

United Nations Development Programme



TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: Request for Proposal for "RFP for Technical assistance to Ministry of Finance and Economy on Employment and VET policy reform".

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive proposals from interested companies who wish to be considered for the above-mentioned service.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The proposal must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked **UNDP/RFP/2019-54717 "RFP for Technical assistance to Ministry of Finance and Economy on Employment and VET policy reform"**.

For more details, please refer to the link below:

http://procurement-notice.undp.org/view_notice.cfm?notice_id=54717

Relevant dates: All interested entities should provide their proposal, not later than **24 April 2019, 14.30 hrs.**, to the address:

United Nations Development Programme
"Skenderbej" Street, Gurten Center, 2nd Floor,
Tirana, Albania
UNDP Procurement team

unicef for every child

UNITED NATIONS CHILDREN'S FUND (UNICEF)
Albania Country office

INVITATION TO BID

Subject: EXTENDED DEADLINE - Sale of UNICEF Office vehicles.

The United Nations Children's Fund (UNICEF) is seeking to receive bids from interested companies/individuals who wish to be considered for the purchase of two UNICEF vehicles.

Please consult UNICEF Albania website at (<https://www.unicef.org/albania/suppliers-and-service-providers>) and UN Albania website at (<http://www.un.org/al/employment-and-procurement>) to get further information on the vehicles, terms and conditions of the bid and to see the photos of the vehicles.

The proposals will be evaluated and selected in accordance with established UNICEF procedures.

The bids must be delivered, in a sealed envelope, which must be clearly marked: "**BID for Purchase of UNICEF Albania vehicles**" - Name of the entity, - Contact details", to the following address:

United Nations Children's Fund (UNICEF)
Rr. "Skenderbej", ndërtesa e Agjencive të OKB-së, kati i tretë,
Tiranë, Albania
Tel.: +355 4 454 8400
Website: www.unicef.org/albania

Relevant Dates: All interested companies/individuals must submit their bid, not later than **16:30 hr. at 25 April 2019.**

Një proces monitorimi i ndërmarrë nga Ministria e Infrastrukturës ka gjetur shkelje të rënda në disa kontrata për ndërtimin e HEC-ve të vogla me koncesion. Zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Hantini Bonati tha se nga vijimi i procesit të skanimit kanë rezultuar edhe 9 raste të tjera të shkeljeve të kushteve kontraktuale nga ana e subjekteve, për të cilat do të fillohet procedura për ndërprerjen në mënyrë të njëanshme të kontratës. Deri më tani, numri total i praktikave për të cilat ka filluar procesi i ndërprerjes në mënyrë të njëanshme të kontratave koncesionare shkon në 17 raste. Bonati

Shkelje dhe abuzime, qeveria prish në mënyrë të njëanshme 17 kontrata HEC-esh

PROBLEMATIKAT

Problematikat e konstatuara në mënyrë të përsëritur gjatë këtij procesi skanimi po analizohen në funksion të riinzhierimit të së gjithë procedurës për lidhjen e kontratave koncesionare, sikurse edhe për procesin e monitorimit dhe kontrollit të kësaj të fundit.

thë se procesi i skanimit të situatës mbi korrektesinë e zbatimit të detyrimeve kontraktuale nga ana e subjekteve që kanë përfutur kontrata për ndërtimin e HEC-ve ka vijuar me ritme të shpejta, sipas planit të har-

tuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Në zbatim të Urdhrit nr. 47 dhe nr. 48, datë 30.1.2019, "Për verifikimin e zbatimit të kushteve të kontratave koncesionare dhe kontratave objekt i Vendimit të Këshil-

lit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015, për burimet hidrike të energjisë" janë marrë të gjitha masat për të adresuar problematikat e identifikuar deri më sot, ku më të shpeshtat janë mosrespektimi i afateve procedurale, mosrespektimi i kushteve ligjore dhe kriterëve në kontratat dhe lejet e lëshuara. Nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore tashmë ka përfunduar procesi i monitorimit dhe verifikimit të situatës në terren dhe puna është fokusuar në praktikën do-



kumentare dhe në koordinimin e qëndrimeve me institucionet e tjera si me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore për të dalë në konkluzionet finale mbi procedurat dhe hapat që do

të ndiqen. Sikurse është thekruar edhe më parë, nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë po procedohet me kujdes për të minimizuar risqet e mundshme dhe implikimet financiare për Buxhetin e Shtetit.

Guvernatori, në mbledhjen e pranverës të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore

Gent Sejko: Ristrukturimi i bankave do të rrisë kreditimin

"Shqipëria, me perspektivë të rritjes ekonomike"

Masat që ka ndërmarrë Banka e Shqipërisë për nxitjen e konkurrencës dhe rritjen e kreditimit janë prezantuar nga guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, në mbledhjet e pranverës të FMN dhe BB-së. Guvernatori bëri një pasqyrë të masave të ndërmarrura nga Banka e Shqipërisë për të garantuar një sektor bankar të qëndrueshëm, likuid dhe të mirëkapitalizuar. Aktualisht, ky sektor përshkoi një fazë ristrukturimi me futjen e aktorëve të rinj dhe bashkimin e disa bankave. Sejko nënvizoi se këto ndryshime janë kryer në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe Banka e Shqipërisë mbetet e angazhuar të ushtrojë një mbikëqyrje të kujdesshme për një veprimtari të shëndetshme bankare. Ristrukturimi i sektorit bankar është zhvillim pozitiv, i cili pritet të ndihmojë në rritjen e konkurrencës dhe krijimin e kushteve të nevojshme për nxitjen e ritmit të kreditimit në vend. Gjatë takimeve në fjalë, guvernatori Sejko prezantoi zhvillimet më të fundit ekonomike në vend, duke u ndaluar në perspektivën e rritjes ekonomike dhe në zhvillimet e sektorit bankar. Sipas z.Sejko, rritja ekonomike e vendit ka vazhduar trendin pozitiv të saj, mbështetur edhe nga politika monetare stimuluese e Bankës së Shqipërisë. Ky stimul i transmetuar nëpërmjet normave të ulëta të interesit dhe ko-



Guvernatori Gent Sejko, në mbledhjen e pranverës të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore

FMN-BB VLERËSON MARRËDHËNIET ME SHQIPËRINË

Përfaqësuesit e FMN-BB theksuan rëndësinë e bashkërendimit në vazhdimësi të politikës monetare me atë fiskale. Ky bashkërendim ndihmon në forcimin e stabilitetit makroekonomik të vendit dhe rritjen ekonomike afatgjatë. Nga të dyja palët u vlerësuan marrëdhëniet shumë të mira ndërmjet autoriteteve të Shqipërisë dhe FMN-BB-së. Guvernatori Sejko u shprehua falënderimet e tij përfaqësuesve të këtyre institucioneve për mbështetjen dhe asistencën e ofruar në vazhdimësi ndaj Bankës së Shqipërisë dhe institucioneve të tjera në vend.

munikimit të kahut të ardhshëm të politikës monetare ka qenë i përshtatshëm për nxitjen e zhvillimit ekonomik, stabilitetin e tregjeve dhe për kthimin e inflacionit në objektiv. Rruajtja e nivelit të inflacionit në 3% mbetet objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë dhe në këtë drejtim guvernatori Sejko u shpreh se sipas parashikimeve të Bankës së Shqipërisë, inflacioni pritet të kthehet në objektivi brenda vitit 2020. Banka e Shqipërisë mbetet e gatshme të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për respektimin e objektivit të saj kryesor.

Politika monetare do të vijojë të mbetet stimuluese gjatë horizontit afatmesëm, por stimuli monetar do të përshtatet në varësi të faktorëve të rrezikut dhe zhvillimeve në vend. Në fund të 2018-ës, bilanci i bankave u përmirësua, veprimtaria bankare u zgjerua, niveli i kredive me probleme u reduktua dhe kreditimi vijoi trendin e tij rritës. Të gjithë këta tregues kanë kontribuar në rritjen e mëtejshme të aftësisë së sektorit bankar për të mbështetur rritjen ekonomike të vendit dhe për të përballuar rreziqet. Një pikë tjetër e

trajtuar nga guvernatori ishte roli i Bankës së Shqipërisë si Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, i cili po vijon të marrë trajtë nëpërmjet zhvillimit të kuadrin nënligjor, në zbatim të ligjit "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme". Më konkretisht, puna e Banka e Shqipërisë në këtë drejtim ka konsistuar në hartimin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, krijimin e burimeve të reja të financimit për menaxhimin e krizave financiare, si dhe identifikimin e të gjitha elementeve të nevojshme të

gatishmërisë për zbutjen e tyre. Të gjithë këto hapa, së bashku me skemën e sigurimit të depozitave, ndihmojnë Bankën e Shqipërisë të forcojë rolin e saj në garantimin e një sistemi financiar të sigurt. Në përfundim të takimeve, përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare përgëzuan Bankën e Shqipërisë për kontributin e saj në zhvillimin makroekonomik të vendit dhe stabilitetin financiar të tij. Ata theksuan se Banka e Shqipërisë duhet të vazhdojë hapat e ndërmarrë lidhur me planin e masave për reduktimin e kredive me probleme, nxitjen e kreditimit dhe stimulimin e përdorimit të monedhës kombëtare.

MBLEDHJA

Shqipëria në mbledhjet e pranverës të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), zhvilluar në 12-14 prill 2019, u përfaqësua nga një delegacion i përbashkët, i përbërë nga Banka e Shqipërisë, me përfaqësues guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko; zëvendësguvernatorin e parë, Luljeta Minxhozi si dhe drejtues të tjerë të lartë të bankës; nga Ministria e Financave me përfaqësues ministren e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj; zëvendësministrin Erjon Luçi si dhe drejtues të tjerë të lartë të këtij institucioni. Agjencia e Sigurimit të Depozitave kishte përfaqësues drejtorin e përgjithshëm të kësaj Agjencie, Gençi Mamani.

SHKURT

Drejtuesit e Tatimeve dhe Doganave: Bashkëpunimi kundër evazionit

Drejtuesit e rinj të Tati Dimeve dhe Doganave nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucionale, duke përcaktuar edhe një plan pune të përbashkët. Referuar njoftimit zyrtar të bërë nga dy drejtoritë të rëndësishme, dy drejtuesit ai i Tatimeve Enton Duro dhe ai i Doganave, Arlind Gjukuta zhvilluan një takim të përbashkët ku përcaktuan se dy agjencitë do të vijojnë me takime periodike çdo muaj, në nivele teknike, për të modeluar një qasje të përbashkët efektive. "Bashkëpunimi do të vijojë edhe në sigurimin e shkëmbimit të informacionit, përfshirë atë në kohë reale si edhe mbështetjen reciproke për të parandaluar dhe luftuar evazionin fiskal dhe aktivitetet të tjera të paligjshme", shkruhet në njoftim.

S'ka më komision për taksitë, certifikatat me vetëdeklarim

Duke nisur nga dita e sotme, automjetet e licencuara për transport udhëtarësh dhe taksitë nuk do të kenë nevojë të paraqiten në komision, por mund të bëjnë vetëdeklarim online. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ka njoftuar se duke nisur nga 15 prilli do të aplikohet procedura e re që thjeshton procedurën e rinovimit të komoditetit (detyrim për të gjithë zotëruarit e mjeteve të licencuara për transport udhëtarësh e taksitë) duke ofruar rinovimin me vetëdeklarim online. Referuar njoftimit, kontrolli do jetë më i shkurt sesa te pika e kolaudimit. "I zoti i mjetit bëhet përgjegjës për vetëdeklarimin dhe merr certifikatën pa qenë nevojë të dalë çdo vit në komision, pa vërdallosje me mjetin, pa shpenzim kohe e karburanti, por edhe pa burokraci e muhabete", shkruhet në njoftimin e DPSHTRR.

Komisioneri për Zgjerim i BE: Mund të ketë shkëmbim territoresh

Kryeministri drejton gishtin nga Brukseli, Haradinaj: Fajin e kanë Mogherini dhe Hahn!

Komisioneri për Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit, Johannes Hahn ka folur rreth një marrëveshje të mundshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Shpresa e tij është që zgjidhja e mosmarrëveshjes të emrit të Maqedonisë do të shërbejë si pararendës ndaj zgjidhjeve të konflikteve të tjera, duke përfshirë edhe në dialogun midis Kosovës dhe Serbisë, transmeton "EO". Megjithatë, duke folur rreth një marrëveshje të mundshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, përkatësisht rreth mundësisë së "korrigjimit të kufijve", Hahn theksoi se

një marrëveshje ligjërisht detyruese midis dy do të mbulonte fushat përtej kufijve dhe se "një element themelor në një marrëveshje të ardhshme duhet të jetë respektimi i të drejtave të pakicave". "Tani për tani, askush nuk mund të parashikojë se çfarë do të ishte një rezultat final", citohej të ketë thënë ai, duke shtuar se edhe "një shkëmbim i mundshëm i territorit mund të jetë si pjesë e saj - nëse palët dëshirojnë". "Parakushti i vetëm që kemi ngritur është se çdo lloj marrëveshje dypalëshe duhet të kon-

tribuojë për më shumë paqe dhe stabilitet në rajon". Gjithsesi, një marrëveshje politike që vjen me koston e të tjerëve, tha Hahn, do të ishte e paprueshme për Bashkimin Evropian. Nga ana tjetër, gjithë fajin për mosarritjen e deritashme të marrëveshjes përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj ia ka hedhur përfaqësueses së lartë të BE-së, Frederica Mogherini dhe Komisionerit për Zgjerim, Johannes Hahn. Sipas tij, sikur ata të mos kishin

folur për kufijtë dhe territoret, do të ishte mundësia që Kosova dhe Serbia, të arrijnë një marrëveshje. Ndërsa nuk pret që me diskutime për kufijtë të ketë marrëveshje as vitin e ardhshëm. Ramush Haradinaj, kryeministër i Kosovës: Vazhdim i gabimit që e ka bërë zonja Mogherini dhe Komisioneri Hahn që ja kanë humbur 1 vit BE - së dhe Ballkanit. Sikur të mos kishin folur për kufijtë dhe territoret, ndoshta do të kishim një marrëveshje. Një deklaratë që e le të hapur për mundësinë e bisedimit të territorit të



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj

kufirit është vazhdim i politikës së gabuar të evropianëve që po shkojnë. Ai është i bindur se delegacioni shtetëror nuk ka mandat negociimi për kufijtë. Delegacioni shtetëror për dialogun është formuar së

fundmi në Kosovë. Ndërsa është presidenti Hashim Thaçi ai që ka përmendur korrigjimin e kufijve derisa kjo çështje kundërshtohet fuqishëm nga kryeministri Ramush Haradinaj dhe opozita.

Presidenti i Kosovës: Këtë vit mund të arrijmë marrëveshje me Serbinë

Takimi me Thaçin, Hahn i vendosur: Të pezullohet taksa

"The Guardian": Gjermania kundërshtoi korrigjimin e territorit

Johannes Hahn, Komisioneri për Zgjerimin e Bashkimit Evropian, ka zhvilluar ditën e djeshme një takim me kreun e Kosovës, Hashim Thaçi lidhur me diskutimin për dialogun me Serbinë. Më pas Hahn ka reaguar në "Twitter" ku shkruan se është i një rëndësie të veçantë procesi i rinisjes së dialogut mes Prishtinës dhe Beogradit. Ai u ndal edhe tek pika më e nxehtë, ajo e taksës, ndërsa kërkoi që sa më parë të merren masa pezullimi dhe më pas lëvizja e mallrave të bëhet pa barriera mes Kosovës dhe Serbisë. "Takim i mirë me Presidentin Hashim Thaçi. Është e rëndësishme që dialogu Serbi-Kosovë të rinisë me shpejtësi, gjithashtu, është në interes të stabilitetit dhe progresit më të gjerë rajonal. Unë përsërita qëndrimin e Bashkimit Evropian se tarifat kontradiktore të Kosovës duhet të paktën të pezullohen", shkruan Hahn. Një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë dhe në linjë me marrëveshjen historike ndërmjet Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut është ende e mundur në vitin 2019, pavarësisht pengesave të rënda në muajt e fundit. Kështu, ka thënë tha presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, shkruan prestigjiozja britanike "The Guardian". Ajo shkruan se Serbia ka refuzuar të njohë Kosovën si një shtet i pavarur, e cila shpall pavarësinë në vitin 2008 pas puthuajse një dekade të administratës ndërkombëtare, pas një lufte të përgjakshme në vitet 1998-99. Lufta, shk-



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe Komisioneri për Zgjerimin e Bashkimit Evropian, Johannes Hahn

HASHIM THAÇI

"Ne duhet të ulemi edhe me armiqtë tanë, por pa asnjë parakusht dhe të përqipemi të dëgojmë njëri tjetrin", - ka thënë Hashim Thaçi, në intervistën për "The Guardian".

ruan media britanike, e nxitur nga një goditje brutale nga forcat serbe kundër shqiptarëve etnikë të Kosovës, la rreth 10,000 shqiptarë etnikë të vdekur para se një fushatë bombardimi 78-ditore e NATO-s të përfundojë konfliktin - qindra serbë u vranë në sulme hakmarrëse. "Ne duhet të ulemi edhe me armiqtë tanë, por pa asnjë

parakusht dhe të përqipemi të dëgojmë njëri tjetrin", ka thënë Hashim Thaçi, në intervistën për "The Guardian". Bisedimet midis dy vendeve janë pezulluar që nga nëntori, kur Kosova ka vendosur taksën prej 100% për mallrat nga Serbia. Thaçi tha se nuk kishte asnjë plan për të hequr taksën, por theksoi nevojën për

përparim të shpejtë. Hezitimi i ndërkombëtarëve dhe mesazhet e përziera ishin "krijimi i hapësirës për nacionalistët dhe populistët në të dy anët e kufirit", tha ai. Thaçi tha se kishte investuar të gjithë kapitalin politik që kishte ndërtuar gjatë dy dekadave në suksesin e bisedimeve dhe çmimi i dështimit të vazhdueshëm do të ishte në dëm të gjithë rajonit. "Në rrethanat e tanishme, me këto tensione, nuk e kuptoj pse do të vijnë investitorët e huaj dhe të investojnë në rajonin tonë. Vetëm një marrëveshje paqeje do të sjellë prosperitet", citohej të ketë thënë ai. Statusi i tanishëm i Ko-

JOHANNES HAHN
"Është takimi i mirë me Presidentin Hashim Thaçi. Është e rëndësishme që dialogu Serbi-Kosovë të rinisë me shpejtësi, gjithashtu, është në interes të stabilitetit dhe progresit më të gjerë rajonal. Unë përsërita qëndrimin e Bashkimit Evropian se tarifat kontradiktore të Kosovës duhet të paktën të pezullohen", - shkruan Hahn.

bimit të territorit, por ajo është kundërshtuar nga Gjermania, e cila ka frikë se mund të nxisë kërkesat gjysmë të ulëta për kufijtë e tjerë geografikë në Ballkan, duke përfshirë edhe pjesët e dominuara nga serbët e Bosnjës, që të ridrejtohen në linjat etnike. SHBA, me të cilën Thaçi është i afërt, është më i hapur për planin, shkruan ndër të tjera media britanike. Thaçi tha se "demarkacioni i kufirit" do të ishte pjesë e ndonjë marrëveshje gjithëpërfshirëse për njëhojen reciproke. Por ai theksoi se "nuk mund të ketë kufij në linjat etnike. Është e pamundur. Si Kosova ashtu edhe Serbia do të mbeten shtete multietnike". Gjithashtu, siç shkruan ky medium, Kosova vendosi taksë 100% për mallrat serbe dhe Serbia kishte insistuar në heqjen e saj si parakusht për rfillimin e bisedimeve. Imponimi i tarifave çoi në dorëheqjen e katër kryetarëve të komunave në krahinat në veri të Kosovës. "Serbët e Kosovës janë tërhequr nga jeta politike në Kosovë, duke përfshirë policinë dhe gjyqësorin në veri të Kosovës", tha Thaçi. "Askush nuk ka një përgjigje se si të ecet më tej dhe viktimat më të mëdha janë kosovarët, dhe në veçanti serbët e Kosovës".

Barnat apo arrest kardiak, cili ishte fundi i mbretit të 'rock & roll'

Historia e vërtetë e vdekjes së ikonës, Elvis Presli

Mjeku i këngëtarit kishte përshkruar 10 mijë doza për 8 muaj

Reth orës 14:30 të pasdites së 16 gushtit 1977, aktorja Xhinger Alden ishte duke u endur përreth Grace-land, në kërkim të askujt tjetër, veç të fejuarit të saj me famë botërore, Elvis Presli. Mbreti i 'rock & roll', po përgatitej për turneun e tij të fundit, por Alden ishte e shqetësuar, pasi nuk e kishte parë prej disa orësh. Alden nuk pa asnjë shenjë të Preslit, deri kur e kuptoi se dera e banjës ishte hapur. Ajo hyri brenda, dhe siç kujton më vonë "mbeta e paralizuar nga ajo që pashë". Sipas Alden "duket sikur i gjithë trupi i Elvis kishte ngrirë plotësisht në pozicionin ulur, dhe më pas ishte rëzuar përpara". Alden nxitoi t'i vinte në ndihmë, dhe zbuloi një shenjë të frymëmarrjes, edhe pse "fytyra e këngëtarit ishte shprishur, dhe kishte marrë ngjyrë vjollcë", ndërsa sytë e tij "shihnin drejt dhe ishin të përgjakur". Ajo thirri një ambulancë, dhe superstari u dërgua në një spital në Memfis të Tenesit, ku mjekët u përpoqën ta risillnin në vete. Përpjekjet e tyre dështuan, dhe Elvis Presli u shpall i vdekur në orën 15:30, pak më shumë se një orë pasi u gjet. Ishte vetëm 42 vjeç. Por një çështje e debatueshme u ngrit nga ai moment: Si vdiq Elvis? Vdekja e këngëtarit shokoi botën. Vetë presidenti Xhimi Karter bëri një deklaratë, duke deklaruar se këngëtarit kishte "ndryshuar përgjithmonë fytyrën e kulturës popullore amerikane". Ndërkohë, rreth 100 mijë fansa të tronditur, morën pjesë në funeralin e Preslit. Pavarësisht kaosit që shkaktoi vdekja e tij e papritur, nisën të ngrihen pikëpyetje mbi disa fakte të errëta, mbi shkakun e vërtetë të vdekjes së këngëtarit. Tre mjekë që punonin së bashku, Eric Muirhed, Xherri Francisko dhe Noel Florredo, kryen autopsinë e tij. Ekzaminimi zgjati 2 dy orë, Francisko doli dhe dha një informim për mediat. Ai raportoi se "gjetjet para-praktë të autopsisë", tregonin se këngëtarit kishte vdekur nga një "arritmi kardiale", një sulm në zemër, dhe se nuk kishte prova që barnat që ai merrte, kishin luajtur ndonjë rol në vdekjen e tij. Në fakt, kjo nuk ishte një përgjigje e plotë ndaj pyetjes se si vdiq Elvis Presli. Autopsia ende nuk kishte përfunduar në kohën e deklaratës së Franciskos, dhe asnjë prej mjekëve të tjerë nuk e kishte pranuar atë një informim për mediat. Por, megjithëse veprimet e Franciskos kishin qenë të dyshimta, kish-



Elvis Presli

te arsye për të besuar, se ilaçet nuk kishin gisht në atë ngjarje, dhe se përkëqsimi i shëndetit të Preslit ishte thjesht rastësor. Në kohën e vdekjes, Presli ishte shumë mbipeshë. Preferenca e tij ndaj ushqimeve të yndyrshme, sanduicëve dhe ushqimeve të tjera të pashëndetshme ishte e njohur, dhe ai vuajti nga disa sëmundje, përfshirë diabetin, presionin e lartë të gjakut dhe glaukomën. Megjithëse, dieta e tij e dobët mund të ketë kontribuar për shëndetin e tij të sëmurë, kishte një përgjigje më të gjatë ndaj pyetjes se si vdiq Elvis Presli. Edhe kur iu drejtua shtypit, Francisko u bombardua nga e njëjta pyetje: A kishte pas vdekjes ndonjë shenjë të abuzimit me drogën? Vetëm pak javë pas vdekjes së Preslit, 3 nga truporjat e këngëtarit kishin botuar një libër me tregime "Elvis, çfarë ndodhi?", në të cilën ata pohonin, se ylli i muzikës kishte qenë prej kohësh i varur nga amfetaminat. Nga ana e tij, Francisko u përpoq ta shmangte këtë pyetje, duke pretenduar se "shkaku specifik i vdekjes së tij, nuk mund të njihet për 1 javë, ose 2 studime laboratorike që priteshin të ndëmerreshin" duke shtuar, se ka "gjasa që në raste të tilla, shkaku specifik të mos zbulohen kurrë". Kur u krye raporti i toksikologjisë, u duk sikur mjekët ishin përpjekur të fshihnin diçka. Rezultatet treguan se në kohën e vdekjes së Preslit, gjaku i tij përmbante nivele të larta

të dilaudid, percodan, demerol, codeine, dhe 10 lloje të tjera drogërash. Më vonë, do të dilte në përfundimin se Francisko e kishte organizuar konferencën, dhe u përpoq t'i shmangte pyetjet rreth drogës, me kërkesën e anëtarëve të familjes Presli, që ishin të vendosur t'i mbanin fshehur abuzimet me drogën të këngëtarit. Presli u bë i varur nga amfetaminat, që kur ishte në fillim të 20-ave të tij. Këto substanca ishin të ligjshme në Shtetet e Bashkuara deri në vitin 1965. Por, Presli që vuante nga pagjumësia, po merrte edhe barna kundër depresionit, për ta ndihmuar të flinte gjumë natën. Nga fundi i viteve 1960, Presli ishte bërë plotësisht i varur nga drogërat, që i përdorte për të qenë energjik gjatë koncerteve live, dhe për të fjetur gjumë gjatë natës. Ndërkohë ai u lidh me një mjek të papërgjegjshëm. Persley u takua për herë të parë me dr. Xhorxh C. Nikopulos, i njohur edhe si "Dr. Nik" në vitin 1967, kur mjeku e trajtoi atë për një plagë në këmbë. Nikopulos u bë shpejt mjeku personal i Preslit, duke shkuar bashkë me këngëtarin në Las Vegas, dhe duke i siguruar atij shumë doza amfetaminash dhe barbituratësh. Sikurse u shpreh më vonë Nikopulos: "Problemi i Preslit ishte se ai nuk shihte asgjë të gabuar tek përdorimi i tyre. Ai ndjente se duke i marrë ato nga një mjek, nuk ishte i droguari i zakonshëm që shkon të blejë diçka në rrugë". Megjithatë, disa e

konsideronin Nikopulosin si një mjek të papërgjegjshëm. Midis viteve 1975-1977, mjeku kishte shkruar receta për 19.000 doza droge për Preslin. Nga janari deri në gushtin e vitit 1977, ai kishte përshkruar më shumë se 10.000 doza. Tre vjet pas vdekjes së Preslit, Nikopulosit iu pezullua licenca si mjek. Në vitin 1981, ai u nxor në gjyq për dhënien e ilaçeve me tepri ndaj pacientit të tij. Mjeku dëshmoi se ai ishte përpjekur vetëm që pacientit të tij të kuronin gradualisht varësinë e tyre, dhe në fund u lirua. Megjithatë në vitin 1995, licenca si mjek iu hoq përgjithmonë. Një vit më parë, një rihapje e dosjes së vdekjes së Preslit, zbuloi se sulmi në zemër ishte shkak kryesor i vdekjes (megjithëse kjo gjetje mbetet e diskutueshme). Sidoqoft, shumë fansa të Preslit fajësuan Nikopulos për vdekjen e idhullit të tyre, dhe ai mori kërcënime të shumta me vdekje vitet që pasuan. Megjithatë, edhe pse mjeku me siguri e çoi Preslin drejt vdekjes, shkak i vdekjes së tij mund të jetë edhe më tragjik. Një nga efektet anësore të abuzimeve të gjata me qetuesit, është kapsllëku i madh. Meqë ai u gjet pa ndjenja pranë tualetit, ka gjasa që ai të jetë përpjekur të dalë jashtë, duke krijuar shumë presion mbi zemrën e tij tashmë të dobët. Tensionja e kombinuar me obetitimin, sëmundjet e tjera, dhe abuzimet me drogërat, mund t'i kenë shkaktuar Preslit një sulm dhejprurës në zemër.

Marrë nga Bota.al

Zjarrri përftshin katedralen e Notre-Dame në Paris

Kryebashkiakja: Jemi të mobilizuar, njerëzit të respektojnë perimetrin e sigurisë

Një ngjarje e papritur ka ndodhur pasditen e djeshme, ku një zjarr i madh ka përfshirë katedralen e famshme të Notre-Dame në Paris. Pamjet e shpërndara në rrjetet sociale tregojnë tymin e madh që del nga çatia e katedrales. Sipas informacioneve të para besohet që zjarrri ka rënë në pjesën ku po bëhen restaurimet e objektit dhe flakët kanë shpërthyer në zonën poshtë çatisë së katedrales. Televizioni 'BFM' raporton që kisha është evakuuar dhe përreth zonës është vendosur një perimetër sigurie. Nga zjarrri është shembur edhe maja e katedrales. Nuk dihen ende shkaqet e shpërthimit të këtij zjarri. Notre-Dame de Paris (domethënë "Zonja jonë e Parisit") është katedrale mesjetare katolike në Ille de la Cité, qarku i katërt i Parisit, Francë. Katedralja konsiderohet shembulli më i mirë i arkitekturës gotike franceze dhe kisha më e mirë katolike në Francë dhe në botë. Katedralja ka 10 kambana, më e madhja, Emmanuel, është vendosur në kullën jugore dhe peshon pak më shumë se 13 tonë dhe është ngarkuar për të shënuar orët e ditës dhe për raste të ndryshme dhe shërbime. Kjo kambanë gjithmonë bie e para, të paktën 5 sekonda para pjesës tjetër. Deri kohë të fundit ishin katër kambanat e shekullit të 19-të në rrota në kullën veriore, të cilat ishin duke u rrokullisur. Këto kambana duhej të zëvendësonin nëntë që u hoqën nga katedralja gjatë revolucionit dhe u vendosën për shërbime dhe festivale të ndryshme. Kambanat dikur u tundeshin me dorë, përpara se të viheshin në punë motorë elektrikë. Kur u zbulua se madhësia e kambanave mund të lëkundte të gjithë ndërtesën, duke kërcënuar integritetin e saj strukturor, ato u nxorën jashtë përdorimit. Kambanat gjithashtu kishin çekiç të jashtëm për të bërë një dallim nga një tastierë i vogël. Në vitin 1160, për shkak se kisha në Paris ishte bërë "Famulli i mbretërve të Evropës", peshkopi Maurice de Sully e cilësoi katedralen e mëparshme të Parisit, Saint-Étienne (Shën Stephen's), e cila ishte themeluar në shekullin e 4-të, të padenjë rolin e saj të lartë dhe e kishte prishur menjëherë pas marrjes së titullit të peshkopit të Parisit. Sipas legendës, Sully kishte një vizion të një katedraleje të lavdishme të re për Paris. Për të filluar ndërtimin, peshkopi kishte shembur disa shtëpi dhe kishte ndërtuar një rrugë të re për të transportuar materiale për pjesën tjetër të katedrales. Ndërtimi filloi më 1163 gjatë mbretërimit të Louis VII dhe mendimi ndryshon nëse Sully ose Papa Aleksandri III hodhi gurin e themelit të katedrales. Për ndërtimin e katedrales punuan një numër i madh arkitektësh, diçka që e dëshmon edhe lartësitë e ndryshme të kullave. Ndërtimi i katedrales përfundoi në vitin 1345. Për zjarrin e rënë në katedralen e famshme ka reaguar edhe bashkiakja e Parisit, Ane Hidalgo. "Një zjarr i tmerrshëm vazhdon të djegë katedralen e Notre-Dame në Paris. Zjarrfikësit e Parisit po përpiqen të shuajnë flakët. Jemi të mobilizuar maksimalisht dhe ftojme të gjithë njerëzit të respektojnë perimetrin e sigurisë", ka shkruar në "Twitter" Hidalgo.



Grëfhet stilisti: Nga Kosova në Amerikë, si arrita të bëhesha i famshëm

Ja kush është shqiptari që po "çmend" me talentin e tij personazhet e Hollivudit

"Kam mall për gjakun e të parëve, për vendin ku u rrita"

Egla Xhemali

Ishite periudhë e vështirë për Kosovën, kur iu hapën dyert e ëndërrës së madhe. Ai është shembulli i një njeriu që ka realizuar gjithçka me shumë mund. Pasionin dhe profesionin e tij e vlerësojnë në SHBA e kudo ku duart e tij kanë prekur të bukurën. Nazim Salihu jeton në Amerikë që nga viti 1999, ndërsa tregon se dëshira për t'u bërë stilist e kishte ngacmuar që në adoleshencë e fill prej atyre viteve, mori drejtimin e duhur duke u realizuar profesionalisht e duke lobuar për të veçantë përtej oqeanit. Salihu ka përfunduar shkollën "Brio Academy" në Hartford të Connecticutit dhe është i certifikuar si stilist. Është fitues i shumë çmimeve. Për "Gazeta shqiptare" vjen një rrëfim ndryshe i një personazhi, që e vlerësojnë dhe e duan figura të njohura të kulturës dhe artit në botë. Stilisti tregon për rastet kur ka rregulluar disa nga personazhet e njohur të Hollivudit si Luck Welson, Jenifer Aniston, këngëtarin Keny Roger, sportistë e shumë aktorë të tjerë. Më tej, këshilla mjaft të vlefshme vijjnë për flokët, si domos për sezonin e verës që është pranë. Tek rrënojmë përtej punës së tij, me shumë krenari Nazimi na pohon se me stilimin e flokëve tanimë merren edhe vajzat e tij, që janë bërë pjesë e pandarë e skuadrës.

Sa e vështirë ka qenë për ju të depërtoni në SHBA, përmes profesionit?

Me të vërtetë ka qenë një sfida që nuk kam për ta haruar. Në vitin '99, gjatë kohës së luftës në Kosovë, pata fatin që u lajmërua një sponsor në shtetin e Minnesotës, i cili e kishte lokalitë në aeroport (sallon flokësh). U bëra pjesë integrale e sallanit të tij e kështu për 9 vitet e para më dha mundësinë të punoja në profesionin tim.

E veçanta e një stili mi që do e bënit përsëri?

T'ju them të drejtën, ka 3 dekada që merrem çdo ditë me flokun dhe trendet e fundit të modës, të cilat përcipim t'i përcjell në të njëjtën mënyrë dhe të eksperimentoj për t'i bërë edhe më të veçanta ato. Punoj në atë mënyrë që të jem unik dhe të dukem sa më interesante punimet e mia.

Puna juaj ju ka lidhur me shumë personazhe të famshëm. Sa ndryshojnë ata nga



ekrani? Kush prej tyre ju është dukur më me komplekse?

Kam punuar dhe punoj ende me shumë figura publike aktore, këngëtare, të cilat natyrisht me mua janë shumë modeste. Kur shohin që unë e bëj punën me zemër

dhe mendoem që të dukem sa më bukur para ekranit, më çmojnë edhe më shumë. Në përgjithësi, ndodh shpesh që kur i rregulloj dhe shohin një ndryshim në pamje, ndihen mjaft lumtura dhe më vlerësojnë për kreativitetin.

Cilat janë tendencat e fun-



dit që preferojnë femrat për ngjyrën dhe modelin e flokëve?

Çdo gjë që po paraqitet tani nëpër trendet botërore sa i përket stilit të flokëve ka të bëjë me veçantinë e ngjyrave. Është kënaqësi e jashtëzakonshme që të punosh me shumë

lloje ngjyrash e të eksperimentosh me to.

Këshilla që do u jepnit tyre për sezonin veror?

Këshilla ime për sezonin veror sa u përket flokëve është më shumë për pjesën e përdorimit të shampove dhe bal-samit që e rregullon dhe e

mirëmban flokun, duke i dhënë butësinë e dëshiruar. Gjithashtu, këshilloj të përdoren vajra gjatë procesit të krehjes dhe shumë më pak sprajshkëlqimi.

Kenit fituar një sërë çmimesh. Çfarë synoni të arrini më tej?

Po, e vërtetë. Kam marrë shumë çmime për këto tri dekada dhe më besoni kur ju them se qëllimi i vetëm i imi ka qenë ta bëj punën me pasion, si në ditën e parë kur kam filluar ta ushtroj profesionin. Pra, unë suksesin tim e shoh në bazë të punës, që aq shumë e dua. Kam dëshirë të jem rreth njerëzve të botës së artit dhe kulturës, si dhe të lë gjurmë që as pluhuri i kohës të mos mundet t'i fshijë.

Fëmijët janë duke ndjekur rrugën tuaj. Keni ndikuar te zgjedhja e tyre?

Kjo pyetje që më bëtë më jep një emocion të thellë, më bën të ndihem shumë krenar. Kur fëmijët ishin shumë të vegjël, shpesh më kanë ndjekur gjatë punës që bëja, gati për çdo ditë, muaj, vit, me orë të tëra. Tani janë 4 stilista. Një mundem ta veçoj e ajo është vajza e vogël Tina, që merret edhe me efekte filmike dhe për këtë ndihem shumë i lumtur dhe krenar.

Çfarë ju mungon në shumë nga Kosova?

Më duhet të flas shumë për Kosovën time të bukur. Atje u rrita dhe më besoni se ndiej mungesë të madhe për vendin tim. Çdoherë që bëj vizita nëpër Kosovë, e ndiej atë freskinë dhe kënaqësinë e vendit, traditat e popullit tim të dashur, që me të vërtetë më kthen pas në kohë për në viset e vendlindjes. Kam mall për gjakun e të parëve, për vendin ku lindi.

Një komunikim që ju ka ndryshuar rrjedhën e jetës?

Për pjesën e komunikimit, mund t'ju them se ka pasur të shumtë në numër. Kur kam marrë mirënjohje në Europë dhe në SHBA, dy nga ato janë më të veçantat që nuk do t'i harroj kurrë. E para, kur kam marrë lajmin që do të shkoj në SHBA dhe e dyta, kur jam diplomuar në master si "Hairstylist" në vitin 2000 e për të vazhduar me shumë befasi të tjera, që ma bëjnë edhe më të veçantë punën e jetën natyrisht.

Koha më e përshtatshme për të hequr dorë nga gjithçka?

Mund t'ju them se do ta kem shumë të vështirë që të heq dorë nga profesioni im, nga filmi dhe TV që merrem çdo ditë. Lus Zotin që të kem shëndetin edhe të mos ndalem në realizimin e punëve sa më produktive dhe të bukura. Sa i përket punës sime, lodhje për të nuk kam kurrë.



Luana "arratiset" për në Stamboll, me kë të ketë shkuar këtë herë?

E po nëse menduat se pushimeve të saj u erdhi fundi, jeni gabuar. Luana është njëra nga femrat më të ndjekura në "showbiz"-in shqiptar. Moderatoja është mjaft aktive edhe në rrjetet sociale, ku i mban ndjekësit e saj të përditësuar me foto e video të ndryshme. Së fundmi, bukuroshja ka treguar që është "arratisur" për disa ditë relaksi, por nuk shoqërohet as nga Marina, as nga partneri i saj i përfolur, Krenar Çocaj. Siç ka bërë të ditur në "Instagram", Luana ndodhet në Stamboll me stilisten e njohur Blerina Klllokoqi Rugova. Ndoshta mund të jetë ndonjë udhëtim pune, por me siguri do e mësojmë në postimet e ardhshme.



Pas sherrit me Noizyn, Oriola bën veprimin që nuk pritej për pjesëtarët e OTR-së

Pak ditë më parë lajmi se marrëdhënia mes modeles Oriola Marshi dhe reperit Noizy ishte prishur mori vëmendjen e të gjitha mediave. Dy miqtë e ngushtë nuk e ndiqnin më njëri-tjetrin në "Instagram", gjë që ngriti dyshimet se ata i kishin dhënë një herë e mirë fund miqësisë. Pasi u rindoqën në "Instagram" dhe filluan të vlerësonin sërish njëri-tjetrin, e papritura ndodhi. Sërish u kanë dhënë fund ndjekjeve në rrjetet sociale. Kështu, Noizy i përqendruar te koncertet, ndërsa Oriola te modelingu. Siç duket, prishja e marrëdhënies së saj me Noizyn nuk ka ndikuar në shoqërinë me pjesëtarët e tjerë të grupit. Oriola ka treguar mbështetjen e saj për reperin e ri Matolale, i cili ka publikuar këngën e fundit Kapo, të cilën modelja seksi e ka promovuar në "Instagram".



Fansat e Klaudias i bëjnë "gjëmën" Albit: Po të shkon goja lëng!

Balerina shqiptare, e cila po vazhdon karrierën në Itali, Klaudia Pepa, erdhi shumë sensuale në videoklipin e fundit të reperit Getoar Selimit, "Amante". Kërcimi i saj ishte shumë provokues, sensual dhe u pëlqye nga të gjithë. Por, ky kërcim nuk mund të shpëtonte pa u vlerësuar edhe nga ish-bashkëshorti i saj, Albi Nako. Ai ka komentuar në videon e saj në "Instagram" me dy emoji duartrokitjesh. Por, fansat e balerines në disa komente e kanë etiketuar koreografin dhe e pyesin nëse ka ndonjë gjë për të shtuar për pamjet spektakolare që pa. "Albi Nako a ke ndonjë gjë për të shtuar?" i shkruan një komentuese ndërkohë që një tjetër shkruan "Po të shkon lëng goja!". Albi dhe Klaudia na kanë treguar fare mirë që mund të mbash raport të shoqërore edhe pas ndarjes.



INTERVISTA

Sigurisht që jemi ne që i ndërtojmë muret rreth e rrotull, jemi ne që i hedhim muret. Kur them unë që çdo të thotë të jesh hero e të spostosh çdo ditë limitin tënd, që është një element i rëndësishëm të vepra ime

DRIANT ZENELI

Të zhbësh limitet e njerëzve me ëndrra

Fatmira Nikolli

Cështja nuk është më trajtohen Bulqiza e Metalurgjiku i Elbasanit, si zona ku ndodhi tragjedi. Cështja është t'i trajtojmë njerëzit që janë aty me dinjitet, ata e meritojnë.

Duket se ky është thelbi i veprës së Driant Zenelit, me të cilën përfaqësohet Shqipëria në Bienalen e Artit në Venecia në muajin maj. Në një intervistë për "GAZETA SHQIPTARE" ai ndalet gjatë të koncepti dhe motivet që e kanë shtyrë të ndjekë ëndrrat e njerëzve që jetojnë në kushte jo të mira e që megjithatë buzëqeshin. Kërkesa e Driantit ka qenë zhbërja e limiteve të njeriut dhe gjetja e ëndrrave për të treguar dinjitetin e njerëzve të thjeshtë që jetojnë larg nesh e që bartin në shpirt një pasuri të madhe emocionale. "Sigurisht që jemi ne që i ndërtojmë muret rreth e rrotull, jemi ne që i hedhim muret. Kur them unë që çdo të thotë të jesh hero e të spostosh çdo ditë limitin tënd, që është një element i rëndësishëm të vepra ime", thotë ai.

Si i shtyjme kufijtë tanë fizike dhe mendorë pa u bërë superheronj? A mund të bashkëjetojnë e mundura/realja dhe imagjinaria? Në thelb të hulumtimit të Driant Zenelit qëndron ripërkufizimi i dëshmitit, utopisë dhe ëndrrës. Njëpër një rrefimit filmik dhe performancës, Driant Zeneli sfidon përpjekjen ngulmuese të njerëzve ndaj kufijve të tyre, duke nxjerrë në dritë përgjigjet e mundshme të brishtësisë së qenieve njerëzore dhe planetit Tokë. Ai sfidon marrëdhënien fizike dhe metafizike midis njeriut dhe hapësirës, materies dhe ëndrrës, gravitetit dhe kontrollit. 'Maybe the cosmos is not so extraordinary' (2019) është një video-instalacion skulpturor; i cili bazohet në një projekt shumëdisiplinar emërtuar 'Beneath a surface there is just another surface', i cili nisi në vitin 2015 në Metalurgjik, një kompleks industrial dystopian, në qytetin e Elbasanit në Shqipëri. Projekti dhe titulli i tij rrjedhin nga novela fantastiko-shkenore "Drejt Epsilonit të Eridanit" (1983) e shkruar nga fizikani dhe shkrimtari shqiptar Arion Hysenbegas. Instalacioni zhvillohet nga një film me dy kanale, ngjarjet e të cilat zhvillohen në minierat e Bulqizës, një qytet në verilindje të vendit, ku, që prej vitit 1918, është nxjerrë minerali i kromit. Zeneli synon të krijojë tension midis një realiteti shtypës nëntokësor dhe një hapësire utopike të mundësishme dhe çlirimt. 'Maybe the cosmos is not so extraordinary' përpjetit të zbulojë fizikisht aftësinë e së zakonshmes, madje edhe në qoshet e saj më të errëta, për të zgjeruar qenien tonë.

- Shkon në bienale me një tri-

Artisti shpjegon konceptin pas veprës që përfaqëson Shqipërinë në Bienalen e Venecias




ologji, që ka në qendër njerëz të thjeshtë. A keni dashur të bëni heronj njerëzit e thjeshtë?

Gjithnjë kam qenë kurioz ndaj përpjekjeve e ëndrrave që njeriu ka. Kur flasim për përpjekje, nuk flasim më për njerëz të një niveli të caktuar, por flasim vetëm për njerëz, që kanë bërë përpjekje nga politikani, te artisti, nga shkrimtari, punëtori a një fëmijë. Jam tërhequr shumë nga personat që janë kuriozë, që kanë për të më treguar diçka ndryshe. Ndaj vepra "Beneath a surface there's just a surface" përballet me takime me persona, nga Mario, mik i imi i fëmijërisë në Liceun Artistik, nga takimi rastësor me Bujarin e Florën në Metalurgjik kur xhiroja filmën e Marios dhe nga një gjeolog që më flet për ferrokromin. Unë



preka vendet ju udhëton ferrokromi dhe për çfarë shërben ai. Te Bujari unë merrem me mbledhjen e qymyrit dhe të skorieve të ferrokromit. Është si një udhëtim mbrapsht që më çon te



miniera, ku del kjo materie e rëndësishme për prodhimin e shumë materialeve që përdorim çdo ditë: nga lugë e pirunë e udhëtojmë e spostohe mi me ferrokrom, sepse anijet, avionët e kapsulat kozmike janë të bëra prej ferrokromit.

-Ndërkohë që Marion e ke bërë pjesë të veprës duke e ballafaquar me ëndrrat e tij, Bujarin e Florën që pavarësisht punës që bënin, mendja e tyre shkonte larg. Si u përzgjedhën pesë fëmijët e Bulqizës?

Mario lind nga një takim pas shumë vitesh e dëshira e tij kishte qenë të ishte nga toka dhe që të ishte duke u bërë pjesë e filmit që u financua nga MAM Foundation. Kur shkova në Bulqizë si një njeri kurioz për të ditur se çfarë bëhet atje. U nisa me një ish-inxhinier dhe një shok. Të gjithë na pyesnin pse kemi shkuar dhe fakti që unë ju thashë që jam një artist që dua të realizoj një film mes realitetit e fiksionit që do të prezantohet në Bienale, ata u bënë kuriozë. Takova në hotelin kur rrija disa fëmijë. U tregova punët e mia dhe lindi ideja që ata të ishin personazhet e mi, dhe do ishin 5, siç janë 5 personazhet e librit të Arion Hysenbegasit. Edhe ata, si shumë të tjerë në Bulqizë kishin një lidhje me kromin. Nisi kështu dhe më pas vendosëm të kishte një anije kozmike që del prej aty, zhytet në ujë dhe ikën nga planeti. Më pas, kam shkuar disa herë në Bulqizë e kam njohur komunitetin, kam parë vendet ku jetojnë e punojnë dhe vetë fabrikën e pasurimit. His-

toria nis me këta fëmijë, që janë në rëndësishme për prodhimin e shumë materialeve që përdorim çdo ditë: nga lugë e pirunë e udhëtojmë e spostohe mi me ferrokrom, sepse anijet, avionët e kapsulat kozmike janë të bëra prej ferrokromit. Në një farë mënyre u bë një kthim mbrapsht i rrugës së kromit, e kromin e nxjerrin njerëzit. Çdo mineral ishte ildhur me histori njerëzore dhe kjo m'u duk metaforë shumë e fortë.

-Diçka mes fiksionit e reales. Duket sikur, ëndrra e çdo njeriu është të shkojë drejt një bote më mirë, pavarësisht se cilat janë kushtet e dhëna. Alicia Knock më duket e cilësoi të dhimbshme nevojën që ka njeriu për të t'kur diku, gjithnjë.

Kam takuar njerëz që jetojnë në kryeqytete të mëdha e që prapë ëndërrojnë të ikin nga ai vend. Është shumë absurd ndonjëherë njeriu, ndaj lind edhe arti, si një lloj kontraktit e nevojshmërie e njeriut për t'u shkëputur. Dikush ëndërron të shkojë në Paris, e dikush do ta gjente qetësinë në një fshat të thellë në Afrikë. Ka një lloj melankolie vepra sidomos në fund. Alicia ka ardhur e ka ndjekur gjithë procesin e kemi takuar fëmijët, Marion dhe Bujarin. Pikëpamja e saj është pikëpamja e një njeriu që jeton jashtë e ndjen këto emocione kur takon njerëz të bukur e kuriozë e që ndjen që ka dhimbje e dëshitime, njerëz që duan të largohen.

- Mario, personazhi i filmit të parë, që ndryshe nga personazhet e filmit të



RESTAURIMI

Makina të tonazhit të rëndë mbi kalldrëm në Gjirokastrë

Deputetja dhe ish-ministrja e Kulturës Mirela Kumbaro ka reaguar sa i takon kalimit të makinave të tonazhit të rëndë në zonën historike të Gjirokastrës. Përmes një postimi në Facebook, ajo sqaron gjithë situatën duke i kaluar një pjesë të përgjegjësisë bashkisë.

"Edhe një herë për kalldrëmet e Gjirokastrës, fiksimin e gjirokastroitëve por edhe timin. Javën që shkoi doli një sèkëlidi e re: një pjesë e kalldrëmit, para zyrrave të Këshillit të Qarkut, që ishte riparuar pjesërisht para 3 javësh, duket se ka çaluar në 'qëndisjen' e gurëve dhe padyshim kjo na shqetëson, sidomos kur shohim nga ana tjetër, se me sa kujdes po bëhet kalldrëmi në të gjithë Qafën e Pazarit, ku mjeshtra nga Gjirokastra e Berati, po punojnë gur, gur për ta bërë rruazë", shkruan deputetja e PS.

Në përgjigje të mesazheve që ka marrë nga miq gjirokastroitë, Kumbaro thotë se ka kontaktuar përgjegjësit e kompanisë zbatuese të projektit të cilët i shpjeguan se pikërisht në atë pjesë të kalldrëmit, që do duhet të ishte i bllokuar për qarkullimin e makinave derisa të mbyllet procesi i punës, kanë kaluar makina të tonazhit të rëndë dhe kjo ka sjellë dëmtim të pjesshëm të kalldrëmit

Mirela Kumbaro: Pjesa dëmtuar do të shqepet dhe do të bëhet sërish nga e para



Ish-ministrja, bashkisë: Të mos lejohet qarkullimi sa kohë kantieri është i hapur

ende të pastabilizuar.

"Natyrisht që ajo pjesë e kalldrëmit të dëmtuar do të shqepet dhe do të bëhet sërish nga e para, dhe do të garantohet pa dyshim cilësia dhe fortësia, njësoj si në pjesën tjetër, ku çdo ditë admirojmë punën e ustallarëve duarartë. POR, dua të tërheq vëmendjen sidomos të Bashkisë Gjirokastrë, që të jetë bashkëpunuese me kompaninë dhe ustallarët me qëllim që të mos lejohet qarkullimi i automjeteve ndërkohe që kantieri është i hapur, por edhe që duhet të punojë për të përgatitur komunitetin dhe tregtarët që Qafa e Pazarit të bëhet përfundimisht këmbësore", shkruan Kumbaro. Sipas saj, nuk ka kuptim që në një anë punohet e në anën tjetër policia bashkiake u hap udhë automjeteve të rënda.

"Është e domosdoshme që të jemi të gjithë bashkëpunues e mirëkuptues për të mirën e projektit më të madh të restaurimit që është bërë në Gjirokastrë, nëse e duam vërtet cilësinë e punës. Nuk mbrohet puna vetëm duke sharë e fyer në Facebook ata që punojnë,

e ca më keq duke fërkuar barkun djallëzisht kur një gur shkon shtrëmbër, por duke qenë konstruktiv e bashkëpunues në terren. Ndjek çdo ditë punimet e kalldrëmeve në Gjirokastrë, sepse është punë delikate, por edhe sepse, tashmë prej 3 vjetësh, Qafa e Pazarit është kthyer në një tablo të bukur që restaurohet si në një laborator të hapur ku marrin pjesë: mjeshtrat e ustallarët të cilëve nuk u ndihet zëri po u shihet puna, gjirokastroitët që duhet të jetojnë çdo ditë me sfidën e kantierit në zemër të qytetit, turistët që megjithatë nuk i ndalin shëtitjet e tyre dhe fjalët e mira për qytetin që magjeps, të gjithë ne që i nisëm, i projektoam, i investuam por dhe kemi padyshim përgjegjësinë t'i mbikëqyrim dhe t'i ndjekim projektet deri sa të bitiset me sukses kjo punë, siç mbyllëm mbarë e bukur edhe fasadat, çatitë e objektet e Pazarit", shkruan Mirela Kumbaro.

"Në fund, thotë ajo, natyrisht edhe të pakënaqurit e përjetshëm që mezi presin të gjejnë qimen që pastaj të shtyjnë kohën në Facebook për ta bërë tra."

← **dytë e të tretë i ka pasur mundësitë t'i realizojë ëndrrat e tij, por diku ka ngecur. Pra, "Nën sipërfaqe, ka një tjetër sipërfaqe".**

Jeta jonë, duket se është njëherësh edhe burgu jonë, sepse edhe?

Sigurisht që jemi ne që i ndërtojmë muret rreth e rrotull, jemi ne që i hedhim muret. Kur them unë që çdo të thotë të jesh hero e të spostosh çdo ditë limitin tënd, që është një element i rëndësishëm te vepra ime, siç është graviteti, ëndrra, dështimi- elementet që të bëjnë të shtysh konfliktin që ke çdo ditë me realitetin. Marion e takoj në një çast të jetës së tij që ndjehej ashtu, sot ai nuk ka nevojë të lërë planetin Tokë. Ai ndërton diçka reth e rrotull atij planeti. Bujari dhe Flora (video 2, babë e bijë) nuk duan ta kenë planetin tokë por duan të respektohen më shumë nga planeti Tokë, ndërsa fëmijët e Bulqizës janë akoma në njohe me planetin tokë. Secili nga këta personazhe është kurioz në vetvete dhe tregon diçka.

Përtej historisë dhe personazheve kaq të ndryshme nga njëri-tjetri, përtej kromit, ti vetë, çfarë merr prej veprës tënde dhe çfarë do të japësh me të?

Se çfarë do të jap, do ia lë kohës. Gerhard Richter, artist me rëndësi në historinë e artit botëror thotë që "ndonjëherë veprat e mia, janë më inteligjente se sa unë". Ndaj edhe unë shpesh herë mësoj duke parë veprat. Në mënyrë inko-



shiente realizoj diçka dhe më vonë kuptoj më mirë, arsyt që më kanë çuar deri aty. Ajo që kam ndjerë unë pas triologjisë "When Dreams become necessity", ku jam unë personazhi, ndjej nevojën të mos jem më unë "Don Kishoti" i situatës. Duke punuar me njerëzit, kuptoja që ata besonin te ajo që unë bëja.

Sa më të njohura të bëhen historitë e tyre, aq më të rëndësishme do jenë. Zonat e tyre njihen, si Metalurgjiku edhe Bulqiza, por nuk duhet të njihen vetëm si vende tragjike, por edhe si vende ku ka jetë, kur ndërrohet e jetohe. Ajo që theksoj është se vepra e fundit, nuk është për të dramaturgizuar jetën në Bulqizë, por për t'i respektuar ata, sepse ata meritojnë shumë dinjitet. Ka njerëz që ndërrojnë të kenë një shtëpi me pamje

nga Luvri, një shtëpi me pamje nga Koloseu, por kur në shtëpinë e tij, sheh se ai nuk ka më kohë ta shohë Koloseun, sepse jeton mes ankthit të datave e orareve, ndaj nuk di të gesh se cila është pesha. Lumturia është pra shumë relative.

- Një prej skenave është lart një karrocë me kushineta dhe poshtë një dron. Sa është edhe ëndrra jote mes ëndrrave të personazheve?

Sfida më e madhe është të mos harrojmë si kemi qenë fëmijë. Por sigurisht në mënyrë inkoshiente dalin elemente që dikur i ke përdorur. Shohim një karrocë me kushineta, një dron që është fjala e fundit e teknologjisë. Në luamim dhe kishim si simbol shpejtësisë karrocë me kushineta dhe sot është droni. Ka elementë të fëmijërisë

së të gjithëve. Po aty kemi kaspu të kozmike, dhe me intereson distanca që ne krijojmë gjithmonë. Nuk më intereson distanca mes teknologjisë dhe njeriut, por distanca a raporti mes njeriut me njeriun. Nga njerëzit që punojnë në anije kozmike te Bujari që ende gërmon skoriet që njerëzimi e fabrikat kanë lënë. Në të gjitha veprat e mia ka elementë të fëmijërisë, në mënyrë inkoshiente.

- Dalin në këtë punë edhe vizatimet e fëmijërisë. Si u ndjeve kur u përballë me fëmijërinë?

Kam vizatuar fëmijë si shumë të tjerë. Një prej tyre ia kisha dhuruar Merita Selimit që ishte atëkohë mike e familjes sime. Në shtëpinë time nuk ka më asnjë vizatim të asaj kohe. Sot është pedagogë në Akademi dhe artiste që

vizatton shumë.

Ajo më shkroi para një viti që ka gjetur vizatimet e mia dhe tha që donte të m'i rripte. Unë mbeta pak i shokuar, se si paskam qenë e si jam. Për më shumë se 12 vite nuk kam ekspozuar më, sepse nuk më pëlqenin vizatimet e mia, nuk i doja, ishin shumë akademikë dhe më dukej se kisha ngelur te ai modeli akademik që më kishin mësuar dhe isha në konflikt me këtë pjesë. Ky vizatim, mua më çliroi.

- Të çliroi sepse po sa i lirë kishë qenë fëmijë?

Po, krejt i lirë. Dhe është interesante, sepse tregon se që atëherë luaja me hapësirën dhe me limitin e gravitetin. Është bërë më 1989 kur ka rënë muri i Berlinit. U habita që kisha përdorur shumë ngjyra, nuk kishim as televizor me ngjyra e nuk kishim as ngjyra. Ndaj nisa të vizatoj edhe për veprën. Në secilin vizatim kam vënë fraza nga libri duke krijuar histori paralele. Është si kur ishim fëmijë: ku lugu e përdornim edhe si mikrofon ose personazh, librin e përdornim si mur, gotën e përdornim në një element tjetër. Me ato unë realizoja një regji, një film që krijonte histori paralele me sendet që kisha. Është e njëjta gjë që bëj edhe sot. Dhe konflikti im me akademinë ishte ai lloj 'imponimi' që të jepet, të të mësuarit e disa rregullave që nuk të lënë të dalësh prej tyre. Harron ashtu çlirimin dhe kreativitetin. Por edhe kujtesa është diçka me nevojën e dëshirës, nuk është reale, është selektive.

Satira

e Ditës

Mbledhje qeverie në Burrel

Nga Ermal Mulosmani

... Dikur nga mëngjesi e lëshoi dhe bëri nja dy orë të qeta...

Të nesërmen kishte lënë për të mbledhur grupin e punës në zyrë. Por ishte pa terezi dhe mendoi t'i mbledhë të shtëpia e vet. Të vinin tre e nga tre që mos t'i bënin rrëmujë. Djali i vogël e kishte bezdi rrëmujën.

Ndaj e vendosi, të parët të vinin Nafija, Ushtari i mirë Shell dhe Gjeniu.

Nafijes iu duk me rëndësi të madhe që ishte me të parët në radhë. Kishte filluar një dietë këto kohë dhe ndihej si flutur. U lye e u zbukurua për merak. Takoi Ushtarit e mirë Shell dhe Gjenium te Rrapi i Dyshit dhe u nisën. Jo pa emocione. Gjeniu po dridhej.

Jashtë rrethimit të pallatit kishte veç zogj e lulemollë. Nafijes i erdhi një si lezet. Iu kujtua filmi "Lulet e Mollës" dhe delli romantik iu zgjua.

Por shpejt Gjeniu e solli në vete...

U futën brenda në majë të gish-tave. Gjeniu mbylli derën dhe u ulën në dhomën e fundit në të djathtë. Ora shënonte 11.00 dhe Taho po lozte në oborr. U gëzua kur pa Gjenium. Shumë u gëzua sa direkt thirri "Ba, ma lër mua Gjenium se do loz pak symbyllurazi!" Një nënqeshje Zeusiane spikati fytyrën e mrrulor të shefit. "Sigurisht - i tha të birrit. - Se mos ka punë tjetër ky".

Pastaj filloi mbledhja. Nafija po



tregonte që u vodhën ca thasë me euro në Drinas. Me një zë delikat, seksi, në kundërshtim me format jo edhe aq delikate të saj tha: "Fajin e kishte kontraktori shef, nuk kishte asnjë faj Ushtari i mirë Shell. Ky u përpoq sa mundi, madje edhe vrau një nga ata të shkretët. Por, këta qelbësirat e Drinasit, këta kanë përgjegjësinë kryesore".

Moj ti k..., kush i kontrakttoi këta fajtorët e tu, kush i kontrollon këta për zbatimin e rregullave?! Ë, kush po të them?! Dhe

lëshoi grushstin në tavolinë! Ti ia heq përgjegjësinë këtij e ia vë vetes... Hiqja Lenës e vija Prendës..."

Një e qarë u dëgjua nga oborri ku po luante Taho. Ai kishte hipur në shpinën e Gjenium dhe po eglendisej, por kur dëgjoi të bërtitura u tmerrua...

Mbledhja u ndërpre. Ushtari i mirë Shell u mor me pajtimin e tij. I tregoi një përrallë. Shefi i bëri me shenjë Gjenium që të dilte nga rrethimi dhe të luante në oborrin e jashtëm.

Mbledhja vazhdoni sërish. Nafijes i ra çdo dëshirë për të vazhduar me vjedhjen e parave.

E shpëtoi shefi vetë kur e pyeti: "Me Unazën e fshatit çfarë bëhet, se lamë nam. Paratë i kemi marrë, do e bëjmë atë mut rruge, apo të fusim ndonjë njeri në burg nga ata zullumqarët që na kanë trapin me protesta?"

Erdhi momenti i Ushtarit të Mirë Shell. Ky u ngrit në këmbë e filloi të raportonte me solemnitet: "Për çdo natë fus nga 5 fshatarë Unaze brenda..."

"Ulu mër koqe e fol shtruar - i tha shefi. - Ti kujton se je në luftë. Dhe nuk ka fshatarë Unaze. Nuk shkon edhe fshat, edhe Unazë në të njëjtën fjali".

Ushtari u mpak. Me vete mendoi: "Po ky vetë na ka thënë që ky vend është një fshat i vogël". Pastaj u kthjellua, "ç'punë kam unë me mendimin tim"?

"Nafie, pse nuk e bën tenderin e Unazës ti"?

"Është vështirë Shef... Tani, po ta bëjmë tenderin, do ulët shumë çmimi dhe kuptohet që kemi vjedhur. Dhe po të ulët çmimi, ku do i gjejmë ato paratë që ia kemi marrë atij"...

"Shih fol pak me Lalën, Fatmirin, Ndriçimin ta mbyllin këtë gropë. Dhe mos më nxirrni këso vështirësish simbolike. Nuk du vështirësi... boll më shqetësoi ajo e flamosur ëndërr..."

Ndërkohë, dikush erdhi me xitim dhe trokiti në derë. Ishte shefi i sigurimit. Me fytyrë të zbardhur iu drejtua shefit dhe diç i tha në vesh... Shefi nënqeshi pak me ironi...

Ishte vetë Liza në Botën e Vet në hyrje të Pallatit. Kishte marrë vesh që vetëm 3 anëtarë të grupit ishin thirrur dhe ishte bërë bishë. Sidomos kur mori vesh që ishte Nafija aty... Kur pa Gjenium jashtë që luante me Tahn, u bë edhe më keq...

Këtu mbledhja mori një kthesë serioze. Ushtari i mirë Shell doli të luante edhe ai me Tahn...

Gazeta "Express"

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT MË VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Dje në "Deutsche Welle"

Beteja e fundit e Merkelit zhvillohet në Ballkan

Nga: Bodo Weber

... e plotë të marrëdhënies së dyanshme vihet re që nga fillimi i vitit një ofensivë e madhe diplomatike e SHBA për të arritur një marrëveshje bazuar në idenë e këmbimit të territoreve. Ideja publikisht u propagandua nga presidentët e Kosovës dhe Serbisë, Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vučić, në verën e vitit 2018. Sidomos Beogradi nuk është lodhur të flasë për "kompromis" që nga fillimi i fazës finale të dialogut politik në vitin 2012 nën drejtimin e Kancelares, Angela Merkel.

Presidenti Thaçi solli për herë të parë idenë e këmbimit të veriut të banuar kryesisht me serbë në Kosovë me territorin serbojugor të Luginës së Preshevës të banuar kryesisht me shqiptarë, përfshirë edhe njohjen reciproke të të dy vendeve. Për këtë nuk kanë bërë publik ndonjë plan asnjë nga të tre pjesëmarrësit, në bisedimet e mbajtura plotësisht sekret të drejtuara nga e ngarkuara e BE për Politikën e Jashtme, Federica Mogherini e Jashtme, **ALEANCË JO FATSJELLESE E LIDERËVE AUTORITARE BALKANIKË**

Kundër këtij propozimi janë shprehur qeveria gjermane dhe Kancelarja Merkel, që nga mbështetësit e idesë paraqiten si iderprishës. Pse duhet të jenë kundër një ideje të tillë BE dhe SHBA, pyesin ata, nëse të dyja palët bien dakord dhe pse?

Në të vërtetë në këtë propozim bëhet fjalë për diçka tërësisht tjetër, se e paraqesin protagonistët: Për një aleancë jofatsjellese të dy liderëve autoritarë ballkanikë me të ngarkuarën e BE për politikën e jashtme dhe administratën e paparashikueshme të Trumpit, e cila kthen përmbyls dialogun politik si parimet bazë të tre dekadave stabilizim dhe demokratizim të Ballkanit Perëndimor.

Pas luftës së Kosovës ishte Beogradi që e hodhi poshtë kompromisin realist, përfshirë edhe planin e të ngarkuarit të OKB-së, Matti Ahtisaari, të cilin Prishtina u detyrua ta zbatojë njëanshëm duke e shndërruar në rend kushtetues të Republikës së sotme të Kosovës. Vite më vonë ishte Kancelarja Merkel, që përpjekjet e Beogradit për integrim në BE i përdori për zgjidhjen e konfliktit të ngecur të statusit, duke e lidhur anëtarësimin e Serbisë me njohjen e realitetit të humbjes së Kosovës, dhe kështu e mbështetur nga Britania e Madhe dhe SHBA arriti një sukses historik. Në Marrëveshjen e Prillit në vitin 2013, Beogradi e njohu faktikisht Kosovën. Kryeministri i atëhershëm, Ivica Dačić foli publikisht, se politika dhe shoqëria e kanë gënjyer veten një dekadë me radhë, se Kosova është ende pjesë e Serbisë.



NEGOCIATAT SEKRETE SI KTHIM POLITIK MBRAPA

Megjithëse BE asokohe nuk e kishte theksuar në mënyrë eksplícite pikën finale të dialogut, të dyja palët e kishin të qartë që kjo do të thotë normalizim i plotë i marrëdhënieve përfshirë dhe njohje e dyanshme. Kësaj i shërbyen edhe deklaratat e shprehura nga Merkel dhe ministri i atëhershëm i Jashtëm, Westerwelle, se koha e ndryshimeve të kufijve në Ballkan ka marrë fund.

Prandaj negociatat e fundit sekrete paraqesin një kthesë të fortë politike në të kundërt. Motivimi i të dy aktorëve kryesorë është i ndryshëm: Për presidentin Vučić është përpjekja të përdorë dobësinë aktuale politike të BE për të nxjerrë më shumë se sa është e mundur nga kuadri i dialogut, për të cilin është rënë në ujdë. Në të njëjtën kohë ai kërkon të tërheqë vëmendjen nga problemet e brendshme politike, pasojë e konsolidimit autoritar-autokratik të pushtetit me tolerimin e perëndimit.

Kurse presidenti Thaçi i privatizoi negociatat përkundër të gjithë rezistencës të të gjitha partive politike të shqiptarëve të Kosovës, me shpresën e ikjes nga kërcënimin i një akuze nga Gjykatat e Posaqme e BE për krime lufte në fundin e luftës së Kosovës.

Federica Mogherini, paafëzia e së cilës si negociuese e çoi dialogun në një krizë ekzistenciale tani përpiqet dëshpërimisht që dëshitim e saj ta kthejë në sukses,

duke e kthyer në parim mungesën e saj të parimeve. Emëruesi i përbashkët me administratën e Trumpit, i një aksi të pazakontë Bruksel-Uashington qëndron në detyrën e kalimit të parimeve perëndimore liberal-demokratike në favor të një "dealmaking" - ujdibërjeje, në kuptimin që "çdo lloj ujdje është ujdë i mirë". **KËMBIMI I TERRITOREVE DO TË DESTABILIZONTE BALLKANIN**

Pasojat potenciale të një këmbimi terriroresh, legjitimitimi shtojcë që perëndimi do t'i bënte parimit etnoterritorial tri dekada pas përfundimit të Luftërës Ballkanike do të ishin të paimagjinueshme: Eksodi i serbëve që jetojnë me shumicë në jug të Kosovës, që me vetëdije në llogarinë e Vuçiqit lihen mënjënjë, do të ishte i pamënjëshëm, i ndjekur nga konflikte edhe të armatosura mes popullatës serbe në shumicë dhe shqiptarëve të Kosovës në veri.

Do të pasonte destabilizimi etnonacionalist i të gjithë rajonit nga Bosnje-Hercegovina deri në Maqedoni. Procesi i anëtarësimin të vendeve të Ballkanit Perëndimor do të harrohej për një kohë të gjatë. BE e dobësuar nga brenda nga populistët dhe nacionalistët do të rrezikohet ekzistencialisht edhe më shumë. Një ndarje etnoterritoriale e mbështetur nga aktorët perëndimorë do të kishte pasojë të mëdha në përballjen me Rusinë për ruajtjen e integritetit terriroresh të

Ukrainës, me pasojë të paparashikueshme gjeopolitike. **MERKEL DUHET TË MARRË ROL DREJTUES**

Për Kancelaren Merkel zhvillimi aktual do të thotë një lloj beteje e fundit në politikën e jashtme dhe europiane. Brenda BE, Merkel si edhe ministri i saj i Jashtëm socialdemokrati, Heiko Maas janë shprehur më qartazi publikisht kundër idesë. Ky pozicion mbështetet nga shumica e vendeve anëtare, me tyre edhe Spanja e Sllovakia, që nuk e njohin Kosovën. Por ato fshihen sa të mundën pas Gjermanisë, duke shpresuar në rolin drejtues të Kancelares. Merkel duket aktualisht, se po heziton t'i futet kësaj beteje për trashëgiminë politike në fund të epokës së saj.

Për të penguar një marrëveshje këmbimi terriroresh me të gjitha pasojat e saj, duhet që Kancelarja të rimarrë pozicionin e saj drejtues europian në dialogun politik. Në të njëjtën kohë, ajo duhet t'i japë të kuptojë publikisht si Beogradit edhe Prishtinës që në rast të një nënshkrimi të marrëveshjes së këmbimit të territoreve, për shkak të rrezikut për paqen dhe demokracinë në Ballkanin Perëndimor do të shuhej për një kohë të gjatë perspektiva e anëtarësimin në BE. Edhe Bundestagu mund të miratojë një rezolutë përkatëse të grupeve të ndryshme parlamentare.

Përveç kësaj Berlini duhet të grumbullojë pas vetes vende të tjera anëtare të BE për një iniciativë të rifillimit të negociatave të dialogut, të kuadrit fillestar të dialogut. Mbetet të pritët, nëse samiti i synuar më 29 prill, i thirrur nga Kancelarja Merkel dhe presidenti francez, Emmanuel Macron do të jetë një hap i parë në këtë drejtim.

Bodo Weber është studiues i asociuar (Senior Associate) i Institutit Transatlantik të Këshillit për Politikën e Demokratizimit, DPC, me qendër në Berlin.

Në konfliktin mes Kosovës dhe Serbisë është në lojë trashëgimia e Kancelares Merkel në politikën e jashtme, stabiliteti i Europës, por edhe e ardhmja e aleancës perëndimore

HOROSKOPI

DASHI

Do të merrni disa informacione interesante sa i përket profesionit. Një rritje në detyrë ose një shpërbilm financiar mund t'ua bëjnë ditën më të bukur. Gëzojuni suksesit që e keni arritur me shumë sakrificë.

DEMI

Hidhni me kujdes hapat tuaj në këtë ditë. Vetëm kështu do të arrini që të shmangni ndonjë dështim. Niseni mëngjesin tuaj me energji, pozitivitet dhe dëshirë për sukses dhe do të shikoni se do të shpërbleheni.

BINJAKET

Motoni juaj është ndezur dhe është gati për nisje. Asgjë nuk mund t'ju ndalojë që të arrini destinacionin tuaj. Ajo që nevojitet nga ju është pak më shumë kurajë. Mos kini frikë të thoni mendimet tuaja edhe nëse nuk gjeni mbështetje.

GAFORJA

Nëse toni i jetës tuaj sociale duket pak monoton, përipiquni të mendoni për disa ide të reja! Dilni nga rutina juaj dhe shikoni diku ku nuk keni qenë kurrë më parë. Do të shikoni se shumë gjëra do të ndryshojnë në jetën tuaj.

LUANI

Ka shumë energji të paqëndrueshme rreth jush, dhe kjo mund të shkaktojë disa vonesa në planifikime. Lajmi i mirë është se çfarëdo vonesa ndodh tani është për mirë! Pra, nëse ia lejonit vetes që shikoni me rëndësi, do t'i hapni vetes shumë mundësi të reja.

VIRGJERESHA

Lajmi i mirë është se karriera juaj është gati për të marrë një kthesë shumë emocionuese lajmi i keq është se mund të kërkojë edhe më shumë kohë. Ju keni dëshmuar me fakte se jeni të aftë për përgjegjësi që ju janë dhënë në të kaluarën.

PESHORJA

Kur ishte hera e fundit që u ulët dhe patët një reflektim të gjatë me veten tuaj? Duke pasur një bisedë të brendshme do t'ju bëjë shumë të mirë tani, kjo do t'ju ndihmojë të kuptoni disa gjëra që kanë qenë të vështira për ju veçanërisht në dashuri.

AKREPI

Sot, djalli nuk do të fshihet vetëm në detaje, por edhe në dokumente. Mbase këtë në mend kur të firmosësh çdo lloj kontrate. Për fat të mirë, ju keni vëmendje të shkëlqyer sa i përket detajeve. Një lexim i dytë duhet të zbulojë të gjitha gabimet.

SHIGJETARI

Një gjë është e sigurt sot se nuk do të jeni të merrtur! Por kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se dita jote do të jetë e mbushur me aktivitete zbatimese, me projekte tërheqëse ose me aventura interesante.

BRICJAPI

Energjia juaj është jashtëzakonisht e fortë sot dhe vëmendja është në nivelin e duhur. Shfrytëzojeni këtë moment për të realizuar disa projekte që i keni në zemër, por nuk keni pasur mundësi për t'i konkretizuar.

UJORI

Mos u habitni nëse, mendja juaj është fokusuar në gjëra që të tjerëve nuk ju duken interesante. Është me rëndësi që të bëni gjëra, të cilat ju sjellin kënaqësi dhe ju plotësojnë profesionalisht. Në dashuri ju gjithëkoha po ecën me ritmet e duhura.

PESHQIT

Sot nuk favorizoheni për të nënshkruar kontrata ndaj shtytjen për një moment tjetër. Sa i përket çështjeve të dashurisë kërkoher më shumë angazhim nga ana juaj. Në punë mund të përballeni me disa pengesa.

Takimi vendimtar, të mërkurën

Në Itali e bëjnë të sigurt, Edi Reja firmos me Shqipërinë

Në mungesë të zyrtares zimit nga ana e Federatës Shqiptare të Futbollit, nga ana tjetër e Adriatikut vijon zëra të tjerë sa i takon stollit të Kombëtares së Shqipërisë, që vijojnë të konfirmojnë firmën e Edi Rejes në krye të kuqezinjve. "NapoliOnline" e bën të sigurt firmën e Edi Rejas, mes ish-trajnerin e Na-

polit, Lacios dhe Atalantës, që sipas këtij portal, apo edhe mediave shqiptare pritet të zyrtarizohet ditën e nesërme në krye të stollit kuqezij. Sipas gazetarit ita-

lian Khanluka di Marzo, të mërkurën pritet takimi final mes Dukës dhe Rejas, për të caktuar detajet e fundit të marrëveshjes mes trajnerit dhe presidentit të FSHF-së.

Duka kërkon një kontratë dyvjeçare me teknikun e lindur në Gorica, ndërsa vetë Reja preferon një angazhim njëvjeçar. Por gjithsesi, këto detaje duken lehtësisht të

kalueshme. Vetë presidenti Duka, në përfundim të Asamblesë së Përgjithshme, e cila zhvilloi punimet e saj ditën e sotme, u shpreh se "ende nuk ka asgjë përfundimtare sa i takon trajnerit të ri" dhe se "me përfundimin e asamblesë, tashmë do të mund t'i përkushtohet çështjes së stafit të Kombëtares kuqezij".

Përrjashtohen 9 klube, edhe një vit më parë s'garuan në kampionat, por votuan për presidentin

Asambleja e rekordeve! FSHF mbyll punimet në 80 minuta

Në "Elbasan Arena" triumfojnë vlonjatët 1-2



Jeton Selimi

Më pak se një ndeshje futbollit! Kaq ka zgjatur Asambleja e Përgjithshme e Federatës Shqiptare të Futbollit, e cila kreu punimet e saj ditën e sotme dhe "lau duart" me vetëm 80 minuta mbledhje, ndonëse ishte parashikuar të zgjaste të paktën 4 orë. Në një kohë rekord, FSHF-ja vendos piketat e reja në statut.

Ndonëse gjithçka miratohet me votim të anëtarëve, ashtu si çdo vit, klubet kanë dhënë votën pro për gjithçka. Krahas së drejtës televizive që ka pësuar ndryshim thelbësor, ku federata propozon të bëhet pronare e vetme pa klubet, teksa të gjithë të deleguarit votuan pro, ka një tjetër rregull që ndryshon, këtë herë për pagat. Nëse deri këtë vit klubet sanksionoheshin pas 3 muajve vonesa të pagesës, tani nëse vonesa kalon 30



ditë, atëherë klubi mund të sanksionohet nga DHZK. Gjatë asamblesë u përjashtuan disa anëtarë dhe të shtohen të tjerë. Shënkolli, Vora, Oriku, Internacional dhe Spartaku janë pesë anëtarë të rinj. Ndërkohë Sukthi, Himara, Adriatiku Mamurras, Pojani, Poliani, Bilisht Sport, Fieri, KS Vlora, Olimpik janë përjashtuar. Të gjithë me kartonin jeshil në dorë kanë votuar edhe për ndryshimet në Kodin e Disiplinës dhe e njëjta gjë ka ndodhur edhe për votimet në Kodin e Etikës, ndërkohë që po me kartonin jeshil janë bërë ndryshimet në Rregulloren për Statusin e Lojtarit. Hapja e punimeve të asamblesë u bë nga

presidenti i FSHF-së, Armand Duka, i cili ftoi të pranishmit të mbanin një minutë heshtje për figurat e sportit shqiptar, që kanë humbur jetën në periudhën e fundit. Ajo që ra në sy në këtë asamble është se nga klubet e Superiores, Grigor Tavo, Safet Gjici dhe Pashk Laska ishin presidentët e vetëm të pranishëm në sallë, ndërkohë që klubet e tjera përfaqësohen nga drejtues të ndryshëm. Në të ishin plot 55 delegatë të pranishëm në sallë. Vora, Himara, Shoqata e MiniFutbollit, Elbasani, Kamza, Sukthi, Mamurras janë klubet që nuk kishin paraqitur asnjë dokument për të marrë pjesë.

CHAMPIONS



Murinjo:

Juventus dhe

Barcelona mund

të eliminohen

Zhoze Murinjo paralajmëron, ose ngacmon Juventusin dhe Barcelonën. I intervistuar nga "Russia Today" në prag të ndeshjeve të kthimit çerekfinale të Champions League, teknikun portugez ka thënë se të gjithë duhet të jenë gati për të pritur befasi. Bardhezinjtë presin Ajaksin pas barazimit 1-1 në Amsterdam, ndërsa katalanët, Manchester Junaidin pas fitores 1-0 në "Old Trafford". "Rezultatet tregojnë se të gjithë e kanë një mundësi. Askush nuk e luan ndeshjen e kthimit me mendjen se është kualifikuar ose e kundërta, që kualifikimi nuk është i mundur. Juventus dhe Barcelona kanë vetëm një avantazh të lehtë dhe mund të eliminohen të dyja. Sa i takon Sittit, them se ata do të kualifikohen, por është shumë e vështirë dhe unë kam shumë dyshime. Të tashmë mund t'ia dalë mbanë".

DREJTORI I PARTIZANIT

Drejtori i Partizanit, Olsi Rama, ka folur për mediat pas Asamblesë së Përgjithshme të FSHF-së, ku temë diskutimi natyrisht që ka qenë kampionati dhe titulli kampion, ku të kuqtë janë më pranë se kurrë këtë sezon, pasi kryesojnë me 12 pikë më shumë se Kukësi. Ai ka treguar edhe bisedën që kishte me Gjicin, i cili i ka shprehur se kampionati nuk ka përfunduar ende.

TITULLI

"Nuk është çështje tersi. Nuk urohet ditëlindja përpara se t'i vijë dita. Janë akoma shtatë javë të tjera dhe janë 21 pikë dhe është akoma goxha punë. Më pëlqeu diçka që tha trajneri. Klubi kërkon re-

zultatin, unë kërkoj gjithmonë treqipëshin. Për Partizanin, e rëndësishme është të japë maksimumin në çdo ndeshje dhe të arrijë objektivin sa më shpejt të jetë e mundur".

FESTA

"E veçanta e Partizanit? Besoj që ajo që vazhdon të jetë te Partizani është disiplina, respekti i ndërsjellë midis lojtarëve dhe stafit teknik, rregulli, dëshira e djemve që bëjnë një grup të mrekullueshëm dhe qetësia që kanë pasur në vetëdije që janë një grup i fortë".

EFUORIA

"Detyra ime është që të jem i kujdesshëm në çdo

Rama: Nuk kemi përgatitur asnjë festë, ja batutat me Gjicin

moment dhe të mbaj sa më larg euforinë. Euforia është një faktor që ndonjëherë edhe ndihmon, por më së shumti të dëmton".

GJICI

"Gjici më tha që ende nuk ka përfunduar kampionati. Unë i thashë që ki kujdes vendin e dytë, në kuadër të shakasë".

ASAMBLEJA DHE LIGA

"Është asambleja ime e parë, kështu që nuk kam çfarë të them ndonjë gjë të veçantë. Pres që liga profesioniste të bëhet faktor, pasi jam partizan i ligës. Pretendoj që të marrë shumë herë më sipër dhe të bëjë diferencën në

raport me Superiorene që të krijoj produktin më të qëndrueshëm".

RËNIA

"Le të vijë një herë siguria matematike, më pas do mendoj për gjërat e tjera. Kemi ekip me 25 lojtarë. Kur të vijë siguria matematike, atëherë do të japim hapësira edhe për lojtarët e tjerë".

EUROPA

"Nuk kemi vendosur objektiva. Sigurisht që rritja cilësore e ekipit të bën që ta ngresh stekën. Për ne e rëndësishme është të ruajmë këtë lloj integriteti dhe të përforcohem me ndonjë element cilësor".


"MILANO FINANZA"

Milani del në shitje për 1 miliard dollarë

Forma e dobët në kampionat, por edhe problemet me UEFA-n duket se e kanë zhgënjyer shumë pronarin e Milanit, fondin amerikan "Elliott Management Corporation", që ka vendosur të ndryshojë kurs në lidhje me të ardhmen e tij në krye të shoqërisë kuqezij. Sipas asaj që raporton "Milano Finanza", fondi "Elliott" ka vendosur të shesë Milanin dhe duket se ka interes nga "CVC Capital Partners", një shoqëri me një pasuri prej 52 miliardë dollarësh, e cila mesa duket ka paraqitur një ofertë në drejtim të fondit "Elliott". Sipas "Milano Finanza", kompania britanike e telekomunikacionit, farmaceutikës dhe shërbimeve financiare dëshiron aksionet e "Elliott", aksione që janë 93% e totalit të klubit kuqezij, por oferta e paraqitur nuk ka përbushur pretendimet e pronarëve amerikanë, që duan të paktën 1 miliard dollarë për të shitur aksionet e tyre. Për momentin ende nuk ka një përgjigje nga ana e "CVC", por tashmë është zyrtare, Milani është në shitje dhe dihet edhe gimi i klubit kuqezij.



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Roland ... i një turneu tenistik.
6. Eshhtë përshatja.
12. Lidhin brigje.
13. Eshhtë lëndë helmuese luftarake.
15. Binjakët në klasa.
16. Eshhtë rozë me gossip.
18. Ente Grumbillimi Tiranë.
19. Gjysma e sfidës.
21. Rossi në MotoGp.
24. Qe përmindësh në labirint.
26. Gjysmë rebusi.
28. I famshëm ai i Anne Frank
29. Fillojnë tatëpjetën.
30. Ishite anestetik i parë.
32. Gjysmë ironik.
33. Bates që qe aktor.
35. Eshhtë sport me stil të lirë.
37. Poet i famshëm rus.
39. Luahen në teatër.

41. Një bluzë sportive.
42. Diftong poetik.
43. Tre në Arlington.
44. Sorel aktor
46. Me to bëjnë torta.
48. Janë gjaknxehtët.
52. Ekstremer në lëng.
53. Mund të jetë franceskan.
54. I ndjeri Pascal i Pirandello-s

VERTIKAL

1. Hiddink trainer.
2. Mbyllin një sirtar.
3. Një pije e jona.
4. Rotor pa zë.
5. Mirar arkitekti i famshëm me origjinë shqiptare.
6. Kryejnë veprimet pagesash.
7. Këndonte me Supremes.
8. Mbyllin fushatat.
9. Të fundit në shtëpi.
10. Intriganti i Otello.
11. Eshhtë shahu i fundit.
14. Manovron me cloche.
17. Ishite poeti i metamorfozave
18. Pak enigmatike.
20. Janë për të shkruar nxënësit.
22. I ka tek truri.
23. Inicialete e Reitman.
25. Një pjesë e kandidatëve.
26. Janë nurat një dhe dy.
27. Ndjek një alfa.
29. Vuante etjen e përjetshme.
31. Kërkohej nga poeti.
33. Kanë ura dhe kuverta.
34. Ashtu si kërkton të blejë kopraci.
36. Një sportist në pistë.
38. Inicialet e Harris aktor.
40. Eshhtë mballomë.
45. Parafjalë prejardhjeje.
47. Fillojnë afrimin.
49. Në fillim të vitit.
50. Të fundit në provim.
51. Fillojnë kalimin.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Përhapet me frikë.
6. Kreshniku i volejbollit.
12. Një mund të jetë unik.
13. Ekstremer për naif.
15. Pak praktike
16. Mbyllin një manastir.
17. Vrau Hektorin,
20. I ka tek litri.
21. Një pjesë e gastareve.
23. Skudra e Bergamos.
26. Mund të jetë sitcom në Tv.
29. Janë porositë e fundit.
31. Gjysmë krenar
33. Një që jeton i vetmuar.
34. De Niro aktor.
37. Kufijtë e Tailandës.
38. Fund dhjetori.
39. Safin tenist.
40. Në fund majtas.

VERTIKAL

41. Demek s'ka kufij.
43. Ekstremer në tenis.
44. Mbyllin një spital.
45. Qendër kurimi.
46. Joplin që qe këngëtare.
47. Emri i Zola.
49. Fillojnë ritmin.
50. Gjysma e etheve.
51. Tafili i interpretuar nga Timo Filoko.
52. Skuadra bardheblu.
53. Janë veglat.
1. Fillojnë poshtë.
2. E famshëm ajo e Noes.
3. Fillojnë natën.
4. Tiran pa kufij.
5. Priset nga përçarja.
7. Me të nxjerrin një tapë.
8. Nuk duhet një e tillë.
9. Mbyllin porta.
10. Një mund të jetë fetar.
11. Opera e Mascagni-t.
14. Kanë gjuhë përvëluese
18. Eshhtë laps.
19. Pinci i Dy herë mat.
20. Janë të ndarë nga feja.
21. Qëllojnë me çifte.
22. Ylli në Hollywood.
24. Inicialet e Moravia-s
25. Inicialet e Dreiser.
28. Mund të jetë kinetike.
30. Lionel, as i futbollit.
32. Eshhtë hidrokarbur.
34. Në radhë të parë.
35. Janë topat katastrofikë të dëborës.
36. Janë përhuva vere.
39. Mund të jetë solemne në kishë.
41. Braktisi Didonën.
42. Eshhtë legjenda.
44. Gjysmë alarmi.
48. Institucione Ndërkombëtare Ekonomike.
49. Inicialet e Redford.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

8	9				3			
								1
				4				
	6	4				1	3	
	5	3					8	
1	2		6					
			4			7		
		5	3	9	2			
	7	2	6		3			

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

3	7	6	4	2	8	5	9	1
9	2	8	3	1	5	4	6	7
4	5	1	6	7	9	8	2	3
8	1	7	5	3	2	9	4	6
6	9	2	7	8	4	1	3	5
5	3	4	9	6	1	7	8	2
1	4	9	2	5	3	6	7	8
2	6	5	8	9	7	3	1	4
7	8	3	1	4	6	2	5	9

Argëtim filozofik

- Kush kontrollon të shkuarën kontrollon të ardhmen. Kushdo që kontrollon të tashmen kontrollon të shkuarën.
- Shumë herë ne jemi të mirë, sepse nuk mund të jemi të këqij.
- Në fund, nuk do të kujtojmë fjalët e armiqve tanë, por heshhtjen e miqve tanë.
- Veshët besojnë më vështirë se sytë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

14	1	3	9	16	13	15		5	8	16	M	I	K	E	K	M	S	E					
5		14	5	3	5	4	7	10	2	8	4	2	E	K	A	R	O	M	A	K	E	T	
13	5		15	5	10	5	9	1	4		5	11	K	M	I	L	I	T	A	N	T	E	T
1		15	2	10	1	4	2	15	1		6	1	M	A	T	E	M	A	T	I	K	A	S
1	16		2	4	4	1		5	9	1	5	4	E	K	U	A	N	E	T	A	R	E	T
10	5	17	H		2			6	5	3	8	5	R	E	T	E	E	I	R	A	N	I	
12	11	5	A	9	9		18	5	8	4	5		I	T	R	B	L	A	K	E	L		
3	4	15	K	1		4	4	4	4	4	5	13	M	I	A	R	E	D	E	K	I		
3		10	1	12	17	5		2	3	16		6	2	E	M	E	T	A	L	E	I	S	
1	10		11	5	13	15		5	3	2	1	9	T	E	K	E	M	K	U	M	T		
4	2	18	5	3	1	4		4	3	16	3	2	M	O	R	A	V	I	A	M	A	E	

Thënie të mençura

- Tragjedia në jetë është se po bëhemi
- pleq shumë shpejt dhe të mençur shumë vonë.
- Budallai që ecën, është me më shumë vlerë se dhjetë intelektualë që rrinë.
- Kurrë mos ndalo të buzëqeshësh, edhe kur nuk jeni të lumtur. Dikush mund të bie në dashuri me buzëqeshjen tuaj.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVË TË NUMRIT TË KALUAR

AR K A K A S T R O A M A
D I A N A H A N T I K
A T L A N T I K E O L S
P E I T A R I F A T L E
T T P O L I T I K A N E T
K E N E T A O R A R
P A U L I N R A R I
A K E O T A A D D I M
R U M U N E K T I E R A N
E T J I T E R T A M A N
T E I S O R D I A N E
I N T A R O M A T I T I

FJALËKRYQI (1)

Argëtim filozofik

Argëtim filozofik



FJALËKRYQI (2)

P A B M E L E R G O
R K U P A E M I R A T E
O H A R A D A R O M A T
C I K L I S T E T
S T A D I U M E T A P E L
D I T K A S T E R E J R U E
K E N T N G O P J E V
K A T I A N S I L E S V
K A R N I O L A I R
M A S S I M O Z A N O R E
A M A N A N N A N N
T T E R R E N I E I N E

